



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## TRANSKRIPIT

**i mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 9.12.2025 duke filluar në orën 10:00**

**Luljeta Selimi:-** të nderuar anëtarë të Kuvendit të Kryeqytetit, i nderuar Kryetar i zgjedhur z. Përparim Rama! Të nderuara zonja dhe zotërinj, si dhe të dashur qytetarë të Prishtinës! Përshëndetje për të gjithë ata që e përcjellin punën e këtij Kuvendi! Për ju mediat e shkruara dhe elektronike, njëkohësisht përshëndetje për të gjithë mysafirët dhe të pranishmit në sallë. Përshëndetje e veçantë për ambasadorët e pranishëm. Falënderim i veçantë për pjesëmarrjen tuaj në këtë seancë inauguruese. Ju uroj mirëseardhje! Në ndërkohë, është kënaqësi që jam këtu përballë jush në këtë seancë inauguruese, e cila simbolizon jo vetëm një fillim, por një premtim për punë, përparim dhe përkushtim. Çdo fillim vjen me një përzierje emocionesh dhe me përgjegjësi për detyrën që ju pret, të ndërtojme diçka më të mirë, të lëmë një shenjë pozitive dhe të punojmë me ndershmëri dhe integritet. Qëllimi i kësaj seance është që ju si përfaqësues të zgjedhur të Kuvendit të Kryeqytetit t'i jepni vetes dhe njëri-tjetrit një betim për t'iu përgjigjur pritshmërive që vendi ka ndaj jush. Të nderuar anëtarë, urime për mandatin tuaj! Ju uroj shëndet dhe suksese në punën tuaj. Urime edhe Kryetarit për mandatin e fituar. Suksese dhe na priftë e mbarë të gjithëve! Ftoj të bëhet intonimi i himnit shtetëror dhe atij kombëtar.

**Luljeta Selimi:-** në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, parashihet që seancën inauguruese ta udhëheqë anëtari më i moshuar i Kuvendit të Prishtinës. Është konstatuar se anëtarja më e moshuar në këtë rast, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është zonja Lumnije Mikullovc. Lus zonjën Lumnije të vijë dhe ta marrë fjalën, pastaj të vazhdojmë tutje me seancën.

**Lumnije Mikullovc:-** përshëndetje për të gjithë! Të nderuar anëtarë të rinj të Kuvendit të Kryeqytetit, i nderuar Kryetar i zgjedhur i Prishtinës. Përfaqësues të tjerë, përfaqësues të mediave dhe të gjithë të pranishmit. Mirëseerdhët dhe përshëndetja e veçantë shkon për ambasadorët, të cilët janë prezent sot këtu në sallë.

Kam nderin që si anëtarja më e vjetër, më e moshuar kështu thotë administrata unë jo, ta shpall të hapur mbledhjen inauguruese të mandatit të ri të Kuvendit të Prishtinës. Uroj sinqerisht që mandati

juaj të jetë i mbushur me punë të ndershme, vendime të drejta dhe përkushtim të palëkundur ndaj qytetarëve që na kanë dhënë besimin. Shpresoj që të bëhemi shembull integriteti, vizioni për punën tonë të përbashkët. Ju uroj të gjithëve një legjislaturë të mbarë me punë, përgjegjësi dhe vendime që i shërbejnë qytetarëve tanë. Faleminderit! Sot kemi thirrur mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës dhe po ashtu jemi mbledhur për të diskutuar mbi çështjet e përfshira në rendin e ditës, siç është zgjedhja e kryesuesit të ri të Kuvendit. Para se të fillojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës, së pari konstatojmë praninë e anëtarëve për sigurimin e kuorumit të nevojshëm për zhvillimin e seancës. Prandaj, për këtë çështje lus shërbimin e Kuvendit që të bëjë numërimin e anëtarëve prezent në sallë. Konstatohet se prezent janë 50 anëtarë të Kuvendit.

**Lumnije Mikullovc:** nga shërbimi i Kuvendit jemi të njoftuar se prezent në sallë janë pesëdhjetë veta. Domethënë, kemi kuorum. Anëtarët e Asamblesë konstatojnë se kemi kuorum për vazhdimin e kësaj seance. Pa humbur kohë vazhdojmë me rendin e ditës. Në këtë mbledhje është paraparë rendi i ditës me gjithsej tri pika:

**1. Betimi i anëtarëve të Kuvendit të Kryeqytetit.**

**2. Betimi i Kryetarit të Kryeqytetit.**

**3. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.**

Pa humbur kohë, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës: Betimi i anëtarëve të Kuvendit të Kryeqytetit. Para fillimit të kësaj pike, ju njoftojmë lidhur me zëvendësimet e anëtarëve nga të gjitha grupet politike. Në vend të Kryetarit të emëruar Përparim Rama vjen anëtari i radhës Amir Simnica nga radhët e LDK-së. Në vend të Uran Ismailit vjen anëtari i radhës Trim Sylja nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës. Në vend të anëtarit Bekë Berisha vjen anëtari i radhës Yll Bogaj nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Në vend të anëtares Jeta Statovci vjen anëtari i radhës Jeton Mehmeti nga radhët e subjektit politik Guxo. Vazhdojmë. Në këtë kuadër kërkojmë nga Komisioni për Verifikimin e Mandateve të procedojë me verifikimin e mandateve sipas nenit 35.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Vazhdojmë tutje me propozimet për Komision. Prandaj, për të vijuar në procedurën e betimit të anëtarëve të Kuvendit të Prishtinës, ftojme grupet politike që të paraqesin nga një propozim për përfaqësuesin e tyre në Komisionin për Verifikimin e Mandateve të anëtarëve të Kuvendit të Kryeqytetit. Propozimet nga grupet politike. Radhën e ka Lidhja Demokratike e Kosovës për të dhënë një përfaqësues.

**Jeta Rafuna:** përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar Rama! Të uroj edhe njëherë në emër të Grupit të Asamblesë, për rizgjedhjen tuaj si Kryetar i Kryeqytetit. Po ashtu, uroj të gjithë asambleistët e Kuvendit Komunal për marrjen e detyrës nga sot. Në emër të Grupit të Asambleistëve të LDK-së, për Komisionin për Verifikimin e Mandateve propozojmë asambleistin Amir Simnica.

**Luljeta Selimi:** lus z. Amir Simnica të vijë dhe ta zërë vendin.

**Lumnije Mikullovc:** partia Demokratike e Kosovës, ju lusim ta propozoni anëtarin tuaj.

**Leutrim Retkoceri:-** përshëndetje për të gjithë. Të gjithë anëtarëve të Kuvendit ju uroj një mandat të mbarë. Nga Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës propozojmë z. Agron Canollin për anëtar të Komisionit për Verifikimin e Mandateve. Faleminderit.

**Lumnije Mikullovc:-** vazhdojmë me Lëvizjen Vetëvendosje.

**Gëzim Sveçla:-** përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Përshëndetje e nderuar kryesuese e seancës inauguruese. Të gjithë asambleistëve ju urojmë mandatin të cilin sapo e fillojmë. Lëvizja Vetëvendosje për këtë Komision e propozon asambleistin Besart Krasniqi.

**Lumnije Mikullovc:-** vazhdojmë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

**Kreshnik Smajlaj:-** përshëndetje për të gjithë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon Endrit Gashi.

**Lumnije Mikullovc:-** nga Lidhja e Prishtinës, ju lutem kandidatin tuaj.

**Betim Abdullahu:-** përshëndetje për të gjithë! Urime gjithë asambleistëve të zgjedhur të Kryeqytetit. Urime Kryetarit për rizgjedhjen. Nga Lidhja e Prishtinës propozojmë Teuta Kadiu-Gjinolli.

**Lumnije Mikullovc:-** përbërja e Komisionit është: nga LDK Amir Simnica, nga PDK Agron Canolli, nga Lëvizja Vetëvendosje Besart Krasniqi, nga AAK Endrit Gashi, nga Lidhja e Prishtinës Teuta Kadiu Gjinolli. Ftoj Komisionin për Verifikimin e Mandateve që të tërhiqet për një moment dhe të kryejë verifikimin e listës së mandatarëve të rinj sipas të dhënave dhe certifikimit të siguruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**Amir Simnica:-** përshëndetje për të gjithë! Në emër të Komisionit deklaroj se të gjitha listat dhe nënshkrimet janë në rregull sipas legjislacionit në fuqi. Të gjitha janë në rregull. Ju uroj të gjithëve punë të mbarë dhe suksese. Faleminderit shumë.

**Lumnije Mikullovc:-** vazhdojmë tashmë me rrjedhën e seancës me pikat e ardhshme. Komisioni për Verifikimin e Mandateve ka paraqitur raportin e vet dhe konstatohet se lista e mandatarëve të rinj të Kuvendit të Kryeqytetit është verifikuar dhe është në përputhje me listën e KQZ-së. Konstatohet se në këtë seancë janë të pranishëm 51 anëtarë të Kuvendit të Kryeqytetit, të cilët janë të gatshëm të kryejnë dhënien e betimit. Theksoj se vazhdojmë me betimin e anëtarëve. Të nderuar anëtarë të Kuvendit, para nesh kemi tekstin e betimit sipas ligjit në fuqi. Ju ftoj që të ngrihemi në këmbë duke e lexuar së bashku betimin. Unë, Lumnije Mikullovc, betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anim dhe me ndërgjegje, dhe sipas ligjit, detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë. Betohem!

Bazuar në nenin 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të nënshkruajnë betimin solemn. Tani ju bëjmë thirrje që të nënshkruani Aktin e Betimit. Konstatohet se të gjithë anëtarët e Kuvendit që janë prezent kanë kryer betimin dhe kanë nënshkruar deklaratën zyrtare. Tani që secili prej jush dha betimin solemn, ju uroj me zemër që ta nderojmë këtë përgjegjësi me përkushtim, profesionalizëm dhe ndershmëri. Betimi juaj është shumë më shumë se një zotim ndaj qytetarëve, ndaj ligjit dhe ndaj vlerave që i mbajnë të forta institucionet

tona. Ju uroj suksese dhe punë të mbarë me vazhdimësi. Tani kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: Betimi i Kryetarit të Kryeqytetit. Ftoj Kryetarin e zgjedhur të Kryeqytetit që të dalë para Kuvendit dhe ta bëjë betimin sipas organizimit.

**Përparim Rama:-** faleminderit. Faleminderit shumë. Kënaqësi e veçantë të jem këtu së bashku edhe me ju, të dashur asambleistë. Urime për të gjithë të votuarit në Asamblenë e Kryeqytetit. Na priftë e mbara së bashku. Bazuar në nenin 57 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me rastin e zgjedhjes Kryetar i Komunës, bëj betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, si në vijim: Unë, Përparim Rama, betohem se do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Prishtinës me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë. Faleminderit. Të nderuar qytetarë, asambleistë, ambasadorë, përfaqësues të ambasadave dhe misionëve ndërkombëtare, familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të Policisë së Kosovës, të zjarrfikësve, të KFOR-it, mediave, miq e bashkëpunëtorë. Sot qëndroj para jush me mirënjohjen më të thellë për besimin që qytetarët ma kanë dhënë edhe njëherë. Prishtina foli. Dhe ky besim për mua është vazhdim i përgjegjësisë dhe motivit. Është zotim për të vazhduar punën me përkushtim të palëkundur. Ju faleminderit që na keni besuar drejtimin e qytetit tonë. Faleminderit që besuat në vazhdimin e vizionit transformues për Prishtinën. Po hyjmë në këtë mandat me vendosmërinë për t'i përfunduar projektet kapitale, për të vazhduar investimet në arsim e shëndetësi, në zhvillim rural dhe në të gjithë sektorët që prekin drejtpërdrejt cilësinë e jetës së qytetarëve tanë. Do të vazhdojmë të përkrahim idetë inovative, të mbështesim kreativitetin e rinisë dhe energjinë e tyre për të ardhmen, duke respektuar, restauruar dhe integruar trashëgiminë tonë kolektive me vizionin modern, të cilat Kryeqytetit po i sjellin çmime me renome ndërkombëtare. Kjo është Prishtina. Këta janë profesionistët e saj. Këta janë qytetarët që nuk hoqën kurrë dorë prej këtij qyteti. Dhe këta qytetarë meritojnë zhvillim dhe respekt. Një falënderim i veçantë për institucionet ndërkombëtare dhe ambasadat për bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellë. Do të vazhdojmë t'i kultivojmë këto marrëdhënie me mirënjohje dhe profesionalizëm. Jemi thellësisht mirënjohës për miqësinë e secilit prej jush. Ju faleminderit nga zemra. E dimë se mandati i kaluar nuk ka qenë ashtu siç e kanë merituar qytetarët. Ka pasur bllokada të kalkuluara politikisht, vonesa e pengesa dhe prej tyre më së shumti kanë vuajtur qytetarët. Uroj me zemër që në këtë mandat të reflektojmë dhe të mos e detyrojmë popullin të dëgjojë diskurse përçarëse, të mos e vendosim qytetin peng të kalkulimeve politike. Secili prej nesh jemi të votuar për t'u shërbyer qytetarëve e jo partive politike. Prandaj e kemi për borxh të bëhemi bashkë dhe të punojmë. Të mos projektojmë kriza artificiale. Të mos krijojmë bllokada që e lodhin qytetin, por të punojmë me përgjegjësi të përbashkët për të ardhmen tonë. Ne jemi këtu në shërbim të qytetarëve. Na sfidoni, na kritikoni kërkoni më shumë prej nesh. Kështu bëhemi më të mirë. Kritika e sinqertë është motori i zhvillimit. Ajo e mpreh udhëheqjen. Ne gjithmonë do ta mirëpresim. Le të debatojmë kur duhet, por mos harrojmë kurrë se çka na bashkon; dashnia për Prishtinën dhe detyrimi për të ardhmen tonë dhe për fëmijët tanë. Drejtorët dhe ekipi i kësaj qeverie duhet ta kuptojnë qartë se puna dhe llogaridhënia janë themeli i kësaj detyre. Pres nga secili profesionalizëm, integritet dhe përkushtim qytetar. Unë, si edhe katër vitet e kaluara, do të jem këtu 24 orë, 7 ditë në javë, gati për bashkëpunim dhe për zhvillim. Pa ngjyra politike, pa inate e pa barriera. Qytetarët nuk kanë zgjedhur për t'iu shikuar egot tona, por për të punuar për ta. Uroj që një qeverisje e tillë, e hapur, përgjegjëse dhe vizionare, të jetë shembull edhe në nivel qendror. Ju e dini që unë as nuk jam

ndalur e as nuk do të ndalem para asgjëje kur bëhet fjalë për zhvillimin e Kryeqytetit dhe për të drejtat e qytetarëve tanë. Dhe kështu do të vazhdojë edhe në këtë mandat. Për këtë betohem sot. Prishtina Përtej nuk është vetëm slogan, është drejtim, është kapitulli i dytë në një plan 8-vjeçar për një Kryeqytet që nuk sillet si komunë e zakonshme, por si zemra e Kosovës. Dinamike, digjitale, e gjelbër, e hapur dhe bashkëpunuese. Është bashkëpunuese ndaj rajonit dhe botës si qendër arti, kulture, inovacioni dhe ndërmarrësie. Para nesh kemi projektin madhor të Lojërave Olimpikë Prishtina 2030, një mundësi historike për qytetin dhe për Kosovën. Kjo kërkon bashkim, përkushtim dhe vizion të përbashkët. Kërkon që brezave të ardhshëm, këta kampionë që po na sjellin çmime ndërkombëtare, t'u bëjmë dhe t'u lëmë infrastrukturën sportive që meritojnë dhe që u ka munguar për dekada, dhe t'i japim Prishtinës imazhin pozitiv ndërkombëtar që e ka fituar me punë dhe dinjitet. Të nderuar asambleistë, ky është momenti ynë të ecim përpara me vendosmëri, me energji dhe me dashni për Prishtinën. Bashkë mund ta ndërtojmë Prishtinën e së nesërme, për të cilën edhe ju, si asambleistë, të jeni krenarë me kontributin që keni dhënë. Bashkë të vazhdojmë ta bëjmë Prishtinën një qytet modern, inovativ, të mençur dhe me plot mundësi për të gjithë. Ju faleminderit nga zemra për besimin. Tani është koha për punë të madhe dhe unë jam i gatshëm, si gjithmonë, t'i shërbej Kryeqytetit tonë me respekt, përgjegjësi dhe dashni të pakushtëzuar. Na priftë e mbara! Faleminderit shumë. Faleminderit.

**Lumnije Mikullovc:** - në emër të Kuvendit të Kryeqytetit ju uroj fillim të mbarë dhe mandat me shumë suksese në punë dhe përgjegjësitë që ju presin. Uroj që bashkëpunimi ynë të jetë i frytshëm dhe konstruktiv. Konstatoj se Kryetari ka dhënë dhe ka nënshkruar betimin dhe e merr zyrtarisht detyrën. Të nderuar kolegë, hap procedurën e propozimit sa i përket zgjedhjes së Kryesuesit. Kërkoj nga grupet politike që të propozojnë kandidatët e tyre. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës:

**Jeta Rafuna:** - faleminderit, e nderuar Kryesuese! Pas takimit me grupin e asambleistëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës kemi diskutuar dhe nuk kemi kandidatë për kryesues të Kuvendit Komunal. Faleminderit.

**Lumnije Mikullovc:** - vazhdojmë me grupin tjetër nga Partia Demokratike e Kosovës. Gjithashtu edhe Partia Demokratike e Kosovës nuk jep kandidat. Nga Lëvizja Vetëvendosje:

**Egzon Azemi:** - faleminderit! Ne, duke i uruar Kryetarit Rama detyrën e sapo marrë, e vendosëm disa herë edhe një urim aty tek emri i Kryetarit, ku shkruante urimi i koalicionit LDK, PDK, AAK, NISMA, PSD, etj. Sepse ka edhe shumë. Nuk e di pse po ju pengon asambleistëve të këtij subjekti ky urim, pasi që një gjë e tillë po dëshmohet me vetë mospropozimin e Kryesuesit të Kuvendit. Pra, grupi më i madh parlamentar, në këtë rast Lidhja Demokratike e Kosovës, pati rastin ta propozojë Kryesuesin dhe nuk e propozon. Ndërkohë, urimin për një koalicion kaq gjigant e mohojnë dhe e largojnë letrën. Ju lutem, veç keni durim se e morët fjalën dhe ju dëgjuaam të gjithëve. Kështu që... Nuk e kuptoj këtë inat ndaj Sokolit, ndoshta nga arsyeja pse nuk e kanë propozuar Sokolin. Kështu që, për me zbutë këtë inat ndaj Sokolit, do ta propozoj Sokolin si Kryesues të Kuvendit.

**Lumnije Mikullovc:** - vazhdojmë seancën. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, a ka propozues?

**Kreshnik Smajlaj:** - nuk kemi emër për Kryesues.

**Lumnije Mikullovc:**- nuk ka as Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës emër. Lidhja për Prishtinën, kandidatin, ju lutem.

**Arbenita Murseli Haxholli:**- të nderuar të pranishëm, i nderuari Kryetar, kolegë asambleistë, i nderuari Ambasador, përfaqësues të policisë, të mediave, të shoqërisë civile, mirë se erdhët në seancën për inaugurimin e Kuvendit Komunal. Ju uroj të gjithëve marrjen e pozitës së re, qoftë një rrugëtim i suksesshëm në arritjen e synimeve tona të përbashkëta në mirëqenien e jetës së qytetarëve. Ne, grupi ynë i asambleistëve e kandidojmë z. Fehmi Kupina për pozitën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Faleminderit.

**Lumnije Mikullovc:**- nga Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka, nga PDK nuk ka, nga Lëvizja VV Sokol Havolli, nga Lidhja për Prishtinën Fehmi Kupina. Kërkon fjalën Sokol Havolli.

**Sokol Havolli:**- natyrisht se ky është një propozim i cili... këta e bëjnë për qëllime tjera dhe nuk mund të shkojë si i tillë, sepse unë nuk pranoj të jem në kuadër të propozimeve. Po sigurisht, pak e kanë edhe inatin që kanë mbetur shumë mbrapa atje. Ashtu që edhe parullat politike në një seancë solemne duhet t'i lëmë anash dhe të kalojmë në pikat e rendit të ditës, gjë e cila ishte edhe kërkesë e vazhdueshme e imja, zonja kryesuese. Ju faleminderit! Nuk mund të jem propozim sepse nuk e pranoj atë, edhe për ndonjë pozitë, kush e di çka po të propozojë Vetëvendosja, nuk e pranoj.

**Lumnije Mikullovc:**- konstatoj se kemi në garë vetëm z. Fehmi Kupina. Nuk ka më propozime, mbaron propozimi. Sipas procedurës, para se të vazhdojmë me votimin, duhet të themelohet Komisioni ad hoc për organizimin dhe numërimin e votave. Ftoj grupet politike dhe anëtarët e Kuvendit që të propozojnë emrat për Komisionin. Anëtarë të Komisionit mund të jenë tre ose pesë. Pranohen propozimet për Komision. Komisioni për votim dhe numërimin e votave përbëhet nga... Nga LDK-ja kërkoj një emër.

**Bekim Gashi:**- e nderuara Kryesuese, Kryetar, urime edhe njëherë. Propozojmë Egzon Pacolli.

**Lumnije Mikullovc:**- nga Partia Demokratike e Kosovës.

**Leutrim Retkoceri:**- faleminderit, Kryesuese e seancës! Nga Partia Demokratike e Kosovës propozojmë Fjolla Ukshinaj-Reçica, anëtare të Komisionit të Zgjedhjes së Kryesuesit.

**Lumnije Mikullovc:**- faleminderit! Nga Lëvizja Vetëvendosje.

**Gëzim Sveçla:**- faleminderit, zonja Kryesuese! Veç po ju njoftoj që... sapo është bërë një shkelje, për shkak se më është mohuar e drejta për të propozuar. Nëse e shikoni udhëzimin administrativ mbi zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit Komunal, është shumë i qartë që secili asambleist ka të drejtë të propozojë dikë ose të vetëpropozohet. Unë kisha një propozim, por më u mohua kjo. Unë po besoj që këtu janë edhe vëzhguesit nga ana e MAPL-së dhe kjo është mirë të evidentohet. Mos u ankoni pastaj nëse kjo seancë shpallet e pavlefshme. Tash, me qenë se ju veç keni kaluar në pjesën e formimit të Komisionit, unë nuk po dua me u bërë bllokues. Do ta propozojmë përfaqësuesin tonë, mirëpo të keni parasysh që sapo është bërë një shkelje, e cila ndikon drejtpërdrejt në epilogun e kësaj seance. E propozuara jonë për këtë Komision është Berita Abazi Muhadri.

**Lumnije Mikullovc:**- faleminderit. Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

**Kreshnik Smajlaj:**- i propozuari ynë është Endrit Gashi.

**Lumnije Mikullovc:** - nga Lidhja e Prishtinës.

**Arbenita Murseli Haxholli:**- e nderuara Kryesuese, Lidhja e Prishtinës propozon Betim Abdullahu si anëtar të këtij Komisioni.

**Lumnije Mikullovc:**- komisioni është themeluar. Ju lutem të përgatiteni për procedurën e votimit. Do të kryhet votim i fshehtë për Kryesuesin e Kuvendit. Lus shërbimin e Kuvendit që t'i bëjë gati fletëvotimet për të vazhduar seancën tutje. Kërkoj 10 minuta derisa të bëhen fletëvotimet gati nga shërbimi i Kuvendit. Pas 10 minutave.

**Lumnije Mikullovc:**- lus shërbimin e Kuvendit të na komunikojë nëse kemi kuorum. Kemi kuorum të mjaftueshëm, 51 delegatë/asambleistë. Vazhdojmë. Berita, fjalën e keni ju.

**Berita Abazi:**- filloj t'i thërras të gjithë asambleistët prezentë në sallë për të votuar. Fillon procesi i votimit. Në votim kanë marrë pjesë 37 asambleistë nga 51. Prej 37, 31 vota janë për. Prej 37, 4 vota janë kundër. Prej 37, 2 vota janë abstenim.

Zgjedhet Kryesues i Kuvendit Komunal z. Fehmi Kupina.

**Lumnije Mikullovc:**- bazuar në rezultatet e votimit, konstatoj se Kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit është zgjedhur z. Fehmi Kupina, me: 37 kanë votuar gjithsej, të pavlefshme nuk ka. Sipas votimit tuaj, z. Fehmi Kupina ka marrë 31 vota pro, 4 kundër dhe 2 abstenime. Faleminderit! Urime Kryesuesit të sapozgjedhur, punë të mbarë në udhëheqjen e Asamblesë. Nga ky moment ia kaloj vazhdimin e mbajtjes së seancës. Ju ftoj të vini te foltorja. Ju faleminderit.

**Fehmi Kupina:**- i nderuari Kryetar i Kryeqytetit, z. Përparim Rama, të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar qytetarë të Prishtinës, mysafirë të nderuar. Zonja dhe zotërinj! Fillimisht, më lejoni t'ju shpreh urimet më të mira për Kryetarin e zgjedhur të Kryeqytetit për marrjen e detyrës në mandatin e dytë dhe i dëshiroj punë të mbarë në shërbim të qytetit dhe qytetarëve. Po ashtu uroj të gjithë asambleistët e zgjedhur, me besimin se së bashku do të punojmë me përgjegjësi dhe bashkëpunim për interesin e qytetarëve tanë. Sot është një ditë me rëndësi të veçantë për mua personalisht, por mbi të gjitha për institucionin që të gjithë ne përfaqësojmë. Pranimi i detyrës së Kryesuesit të Kuvendit të Prishtinës është nder i madh, por edhe përgjegjësi e jashtëzakonshme, të cilën e marr me përlusësi, me seriozitet dhe me një ndjenjë të thellë detyrimi ndaj besimit që më keni treguar. Faleminderit secilit prej jush për mbështetjen dhe besimin. Ky besim nuk është një privilegj i thjeshtë. Është një obligim që t'ju udhëheq me profesionalizëm, transparencë dhe paanësi, duke garantuar funksionim të drejtë, të hapur dhe efikas të këtij Kuvendi. Kuvendi i Komunës është zemra demokratike e qytetit tonë. Është vendi ku marrim vendime që prekin secilin qytetar, secilën lagje, fshat apo vendbanim, në drejtim të zhvillimit të këtij qyteti. Është forumi ku debatojmë, ku pajtohemi e ku ndonjëherë edhe përplasemi në ide, por gjithmonë me respekt, me argumente dhe me përgjegjësi. Si Kryesues, angazhimi im do të jetë garantimi i një procesi të drejtë për të gjithë, pa dallim bindjesh politike apo ideologjike. Çdo zë në këtë sallë duhet të dëgjohet dhe çdo propozim duhet të trajtohet me vëmendjen që meriton. Bashkëpunimi

institucional, koordinimi me ekzekutivin dhe hapja ndaj qytetarëve do të jenë shtyllat e punës sime. Ne jetojmë në një Kryeqytet që rritet, zhvillohet dhe përballlet me sfida të reja çdo ditë. Prej nesh pritet të udhëheqim me vizion dhe vendosmëri. Prandaj, ju ftoj të gjithëve që, pavarësisht dallimeve, të gjejmë bashkëpunimin e nevojshëm për projektet madhore të qytetit, si planifikimi urban, mbrojtja e mjedisit, edukimi, kultura, infrastruktura dhe zhvillimi ekonomik. Prishtina është e të gjithëve. Detyra jonë është ta bëjmë atë më funksionale, më të pastër, më të drejtë, më inovative dhe më të orientuar drejt qytetarit. Ne jemi këtu për t'u shërbyer qytetarëve dhe vetëm qytetarëve. Në këtë rrugëtim do të mbështetem në profesionalizmin tuaj, në përvojën tuaj dhe në gatishmërinë tuaj për dialog. Si Kryesues, do t'ju garantoj rend të qartë pune, vendimmarrje të përgjegjshme, transparencë të vazhdueshme dhe respekt të ndërsjellë. Le të punojmë me integritet, me qetësi, me vendosmëri dhe me besim, dhe secilin vendim të mirë ta marrim këtu. Le të kthehet kjo në një të mirë për qytetarët tanë. Ju faleminderit edhe njëherë për besimin. Uroj që puna jonë e përbashkët të jetë shembull i demokracisë lokale, i bashkëpunimit dhe i vizionit për një Prishtinë më të zhvilluar dhe më të drejtë. Ju faleminderit për vëmendjen dhe na priftë e mbara në këtë mandat të ri së bashku. Të nderuar kolegë, Edhe njëherë ju falënderoj dhe jam thellësisht mirënjohës për mbështetjen tuaj. Me këtë rast mbyllem punimet e kësaj seance. Mirupafshim në seancat e radhës. Faleminderit shumë! Një lutje, në anën e majtë, kur dalim jashtë, Kryetari ka organizuar një koktej për të gjithë. Jeni të mirëseardhur të gjithë. Faleminderit shumë!





Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 9.12.2025, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Bujar Gashi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Sokol Havolli (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi-Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Agron Canolli (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Besianë Musmurati (PDK), Ilirik Musliu (PDK), Yll Muriqi (PDK), Granit Geci (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Nora Cimili-Gagica (PDK), Fjolla Vukshinaj-Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Mrika Limani-Myrtaj (PDK), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida-Bujari (LVV), Berita Abazi-Muhadri (LVV), Egzon Azemi (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumnije Mikullovc (LVV), Leonora Shabani-Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Erblina Tahiraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Yll Bogaj (AAK), Fehmi Kupina (Lidhja e Prishtinës), Betim Abdullahu (Lidhja e Prishtinës), Arbenita Murseli-Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu-Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (Guxo).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama- Kryetar i Kryeqytetit, Ambasadorë, përfaqësues të KFOR-it, Policisë së Kosovës, MAPL-së, përfaqësues të OSBE-së dhe të mediave.

**Mbledhjen e hapi:** Luljeta Selimi- udhëheqëse e Sektorit për punë të Kuvendi, dhe e kryesoi Lumnije Mikullovc anëtarja më e moshuar e Kuvendit.

**Luljeta Selimi:-** udhëheqëse e Sektorit për punë të Kuvendit, hapi seancën duke përshëndetur të gjithë të pranishmit në sallë, ndërsa kryetarit dhe anëtarëve të Kuvendit të Kryeqytetit ju uroj shëndet, suksese dhe punë të mbarë. Luljeta tha se duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, seancën inauguruese duhet ta udhëheqë anëtarja më e moshuar nga anëtarët e Kuvendit, prandaj ftoj znj. Lumnie Mikullovc, për të vazhduar me seancën.

**Lumnije Mikullovc:-** anëtarja më e moshuar, vazhdoi me seancën duke përshëndetur të gjithë të pranishmit në sallë. Ajo së pari konstatoi nga zyra e Kuvendit se në sallë janë prezent gjithësej 51 anëtarë, pastaj njoftoi për zëvendësimet të cilat janë bërë në përbërjen e anëtarëve të Kuvendit nga radhët e partive politike. Në vend të kryetarit vjen

anëtari radhës Amir Simnica nga (LDK), zëvendësim i Uran Ismailit vjen anëtari Trim Sylja (PDK), zëvendësim i Bekë Berishës vjen anëtari Yll Bogaj (AAK) dhe Jeton Mehmeti në vend të Jeta Statovci nga subjekti politik (Guxo). Znj. Lumnije tha se për këtë mbledhje është paraparë ky rend dite:

**1. Betimi i anëtarëve të Kuvendit të Kryeqytetit;**

**2. Betimi i Kryetarit të Kryeqytetit;**

**3. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.**

**Znj. Mikullovc:**- tha se para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës duke u bazuar në Nenin 35.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale kërkoj nga grupet parlamentare ta propozoni nga një anëtar për formimin e komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit.

**Jeta Rafuna:**- tha se nga Grupi i Asambleistëve të LDK-së, për anëtarë të Komisionit propozoj z. Amir Simnica.

**Leutrim Retkoceri:**- nga Grupi i Asambleistëve të PDK-së, për anëtarë të Komisionit propozoj z. Agron Canolli.

**Gëzim Sveçla:**- nga Grupi i Asambleistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtarë të Komisionit propozoj z. Besart Krasniqi.

**Kreshnik Smajlaj:**- tha se nga Grupi i Asambleistëve të AAK-së, për anëtarë të Komisionit propozoj z. Endrit Gashi.

**Arbenita Murseli-Haxholli:**- nga Grupi i Asambleistëve të Lidhjes së Prishtinës propozoj znj. Teuta Kadiu-Gjinolli.

**Lumnije Mikullovc:**- kërkoj nga anëtarët e Komisionit të vendosën në pjesë e ulësve të ekzekutivit dhe ta bëjnë verifikimin e mandateve duke u bazuar në listat dhe vendimet zyrtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

**Amir Simnica:**- në emër të Komisionit për Verifikimin e Mandateve deklaroi se duke u bazuar në listat dhe vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të gjithë anëtarët e zgjedhur janë prezent në sallë dhe sipas Legjislacionit në fuqi çdo gjë është në rregull, prandaj mund të vazhdojmë me dhënjen e betimit të anëtarëve të Kuvendit.

**Lumnije Mikullovc:**- tha se pas deklarimit të Komisionit për Verifikimin e Mandateve, ftoj të gjithë anëtarët e Kuvendit të ngrihen në këmbë për dhënjen e betimit si anëtarë të Kuvendit.

**Pika e dytë e rendit të ditës:**

**Betimi i Kryetarit të Kryeqytetit;**

**Kryetari:**- përshëndet të gjithë të pranishmit në sallë dhe para anëtarëve të Kuvendit betohet se do t'i kryej detyrat dhe do t'iu ushtroj kompetencat si kryetar i Komunës së Prishtinës me nder, besnikri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë. Kryetari tha se me mirënjohje të thellë

falenderojë të gjithë qytetarët për besimin e dhënë dhe ky besim do të jetë përgjegjësi dhe motivim për të vazhduar punën me përkushtim të palëkundur. Z. Rama tha se me vendosmëri do të vazhdojmë rrugëtimin tonë drejt përfundimit të projekteve kapitale, do të vazhdojmë me investime në Drejtorinë e Arsimit, Shëndetësisë, Zhvillimin Rural dhe në gjithë sektorët aty ku mund të ndryshojmë drejtëpërdrejt cilësinë e jetës së qytetarëve tonë. Kryetari falenderojë të gjitha institucionet ndërkombëtare dhe ambasadat për bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellë dhe tha se do të vazhdojmë t'i kultivojmë këto marrëdhënie me mirënjohje e me profesionalizëm. Kryetari tha, duke u bazuar nga bllokadat dhe pengesat politike të cilat i kemi kaluar, shpresoj se tash e mbas do të punojmë me përgjegjësi të përbashkët për të mirën e qytetarëve dhe dashninë që kemi ndaj Prishtinës. Ai tha se “Prishtina përtej” nuk është vetëm slogan, është kapitulli i dyti në një plan 8- vjeçar për një Kryqytet që nuk sillet si Komunë e zakonshme, por si zemra e Kosovës, dinamike, digjitale, e gjelbër, e hapur dhe bashkëpunuese ndaj rajonit dhe botës si qendër arti, kulture, inovacioni dhe ndërmarrësie. Z. Rama ju tha anëtarëve të Kuvendit se ky është momenti ynë të ecim përpara me vendosmëri, me energji e me dashni për Prishtinën dhe bashkë mund ta ndërtojmë Prishtinën e së nesërmes, për të cilën edhe ju si asambleistë të jeni krenar me kontributin që keni dhënë.

### **Pika e tretë e rendit të ditës:**

#### **Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit;**

**Lumnije Mikullovc:-** kërkon nga Grupet Parlamentare të propozojnë kandidatët e tyre për kryesues të Kuvendit.

**Jeta Rafuna:-** tha se Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka ndonjë propozim për kandidat për kryesues të Kuvendit.

**Lumnije Mikullovc:-** tha se as nga Partia Demokratike e Kosovës nuk kemi propozim për kryesues të Kuvendit.

**Egzon Azemi:-** tha se i urojmë kryetarit mandatin e ri dhe kualicionin e përbashkët me partitë e tjera si PDK, AAK, PSD, Nisma e të tjerët. Azemi tha se nuk e di pse i pengon anëtarëve të LDK-së kjo gjë, pasi ata kishin mundësinë të propozojnë për kryesues dhe u deklaruan se nuk kanë ndonjë propozim. Ai tha se propozon Sokol Havollin për kryesues të Kuvendit.

**Kreshnik Smajlaj:-** tha se Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk ka ndonjë propozim për kryesues të Kuvendit.

**Arbenita Murseli-Haxholli:-** tha se nga Lidhja e Prishtinës për pozitën e kryesuesit të Kuvendit propozojmë z. Fehmi Kupina.

**Sokol Havolli:-** tha se propozimi për kryesues të Kuvendit i është bërë për arsye të tjera politike dhe nuk pranon propozim për çfarëdo lloji pozite nga Lëvizja Vetëvendosje.

**Lumnije Mikullovc:-** kërkoj nga Grupet Parlamentare të japin propozimet e tyre për formimin e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.

**Bujar Gashi:-** tha se propozon z. Egzon Pacollin për anëtar të Komisionit nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

**Leutrim Retkocei:-** propozon Fjolla Vukshinaj-Reçica nga PDK-ja, për anëtare të Komisionit.

**Gëzim Sveçla:-** deklaroj se më herët i është bërë shkelje në mohimin e të drejtës së fjalës dhe propozimit për kryesues të Kuvendit. Ai theksoj se kjo mbledhje vëzhgohet nga përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit dhe Administrimit Lokal, të cilët do të japin edhe vlersimin për shqyrtimin e ligjëshmërisë së vendimit. Sveçla tha se e propozuar nga grupi jonë për këtë komision është Berita Abazi -Muhadri.

**Kreshnik Smajlaj:-** propozon Endrit Gashin, për anëtarë të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.

**Arbenita Murseli-Haxholli:-** tha se nga Lidhja e Prishtinës propozon Betim Abdullahun për anëtarë të Komisionit.

**Lumnije Mikullovc:-** njofton anëtarë e Kuvendit se pas përgatitjes të procedurave nga Shërbimi i Kuvendit do të vazhdojmë me votimin e kryesuesit të Kuvendit.

**Egzon Pacolli:-** në emër të komisionit, konstatoi se në votim kanë marr pjesë gjithësejtë 37 anëtarë, me 31 vota për, 4 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për zgjedhjen e z. Fehmi Kupina për Kryesues të Kuvendit të Kreqytetit.

**Lumnije Mikullovc:-** uroj z. Fehmi Kupina, për zgjedhjen e kryesuesit duke ftuar për një fjalë rasti.

**Fehmi Kupina:-** uroi Kryetarin e Kryeqytetit dhe asambleistët e zgjedhur duke ju dëshiruar sukses në shërbim të qytetarëve, dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe përgjegjësisë institucionale. Kupina shprehu falënderim për besimin e dhënë për detyrën e Kryesuesit të Kuvendit, duke e cilësuar atë si nder dhe përgjegjësi të lartë dhe theksoi angazhimin për udhëheqje profesionale, transparente, të paanshme dhe funksionim efikas të Kuvendit. Ai nënvizoi rolin e Kuvendit si institucion qendror demokratik në marrjen e vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe garantoj trajtim të barabartë për të gjitha grupet politike dhe dëgjim të çdo propozimi. Kryesuesi ftoi për bashkëpunim në projektet strategjike të qytetit, përfshirë planifikimin urban, mbrojtjen e mjedisit, arsimin, kulturën, infrastrukturën dhe zhvillimin ekonomik, dhe shprehu besimin se puna e përbashkët do të jetë shembull i demokracisë lokale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Prishtinës.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:50.*

**Procesmbajtësi**  
**Arton Brahim**

**Kryesues i Kuvendit**  
**Fehmi Kupina**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština – Municipality of Prishtina**



---

## **TRANSKRIPT**

**I mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit mbajtur më 30.12.2025,  
duke filluar nga ora 11:00**

**Kryesuesi:-** përshëndetje të gjithëve! Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Kryeqytetit, i nderuar Kryetar Rama! Të nderuar përfaqësues të ekzekutivit, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm. Ju përshëndes dhe ju falenderoj për praninë në këtë mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit, e cila është thirrur me kërkesë të kryetarit të Kryeqytetit, lidhur me listën e veçant të pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026. Ftesa për këtë mbledhje është dërguar, besoj me kohë tek të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe bashkë me të janë shpërndarë edhe materialet përkatëse për pikën e rendit të ditës përfshirë të gjitha dokumentet të pranuar nga ekzekutivi. Para se të vazhdojmë me shqyrtimin e rendit të ditës, do të bëjmë verifikimin e kuorumit të nevojshëm për mbajtjen e kësaj mbledhje. Pa humbur kohë, pyes shërbimin e Kuvendit të konstatoj numrin e saktë të anëtarëve, gjithsej 44, faleminderit! Konstatoj se kemi kuorum për mbajtjen të kësaj mbledhje. Pasi është konstatu kuorumi, të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, dhe procedurat e përcaktuara për funksionimin e Kuvendit të Komunës, ju njoftoj se ka ardhë deri te një ndryshim në përbërje të këtij Kuvendi. Në këtë rast, ju informoj se asambleistja znj. Nora Cimili nga radhët e subjektit të Partisë Demokratike është dorëhequr, ndërsa në bazë të verifikimit të mandatit dhe vendimeve përkatëse në përbërjen e Kuvendit të Komunës hyn znj. Arbnora Ajeti, e cila fiton të drejtën për ushtrimin e funksionit të asamblesë. Sipas Nenit 35 pika e 35.4 të Ligjit për Vetçeverisje Lokale, çdo anëtar i Kuvendit të komunës, para fillimit të ushtrimit të

mandatit është i obliguar të jap betimin solemn si akt formal dhe juridik që konfirmon marrjen e përgjegjësisë dhe obligimeve publike. Në këtë rast, ftoj zonjen Arbnora Ajeti që të ngrihet në këmbë, ta përsëris betimin solemn njëkohësisht, bashkërisht sipas teksteve zyrtare të përcaktuar me ligj, dhe ta nënshkruaj atë. Beto hem, beto hem se do të kryej me nderë, besnikri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, detyrat dhe do t'ju ushtroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Beto hem, urime! Pas përfundimit të dhënies së betimit solemn, konstatoj se betimi është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore dhe procedurat përkatëse, dhe se znj. Arbnora Ajeti nga ky moment fiton të gjitha të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga funksioni i asamblesë dhe Kuvendit të Komunës. Pa humbur kohë, vazhdojmë me pikën e rendit të ditës. Propozim - vendimi për miratimin paraprakë të listës së veçantë të pronave të paluajtshme, të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2026. Për këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ia jap drejtorit të Pronës z. Ibrahim Mehmetaj. Fjala për juve z. Mehmetaj.

**Brahim Mehmetaj:-** përshëndetje, kreyetar, përshëndetje kryesues! Përshëndetje kuvendar të Kuvendit të Kryeqytetit nga të gjitha grupet politike që janë prezentë këtu. Përshëndetje, media, qytetarë të nderuar. Duke u bazuar në ligjet në fuqi sot, kam nderin që në emër të Ekzekutivit, të paraqes para jush listën e veçantë të pronave komunale të propozuara për shfrytëzim. Një dokument i rëndësishëm i veçantë për zhvillim ekonomik, social dhe urban të komunës sonë. Kjo listë është startuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, Strategjinë Zhvillimore Komunale, si dhe me parimet e transparencës, interesit publik dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pronës së kryeqytetit. Qëllimi kryesor është që pronat komunale të mos mbesin të pashfrytëzuara, por të vihen në funksion të zhvillimit, krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes së të hyrave për kryeqytetin. Pronat e përfshira në këtë listë janë analizuar me kujdes në aspektin juridik, urbanistik dhe ekonomik. Shfrytëzimi i tyre do të bëhet përmes procedurave të hapura, konkurruese dhe transparente, duke garantuar ruajtjen e pronësisë dhe interesit publik. Kam nderin që ju ftoj ta shqyrtoni këtë listë me seriozitet e përgjegjshmëri. Të jepni sygjerrimet dhe vërejtjet e tua konstruktive dhe në fund të më mbështetni miratimin e saj në mënyrë që të hapim rrugë investimeve të reja dhe zhvillimit të qëndrueshëm të kryeqytetit tonë. Faleminderit shumë!

**Kryesuesi:-** faleminderit, kryetar! Pas fjalës së drejtorit, hapim diskutimin. Fillojmë me grupet. Nga radhët e LDK-së, kush deshiron të marrë fjalën? Jeta Rafuna ka kërkuar fjalën.

**Jeta Rafuna:-** falemnderit, kryesus, i nderuar kryetar! Të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Sot para nesh është vendimi për miratimin e listave të pronave të veçanta për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026. Një çështje me rëndësi të veçantë për menaxhimin e pronës publike dhe për zhvillimin ekonomik e shoqëror të kryeqytetit. Pronat komunale janë pasurie e qytetarëve dhe si të tilla kërkojnë trajtim të përgjithshëm, transparent dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Listat që po shqyrtojmë sot janë rezultat i një procesi profesional, me qëllim që këto prona të vihen në funksion të interesit publik dhe të mos mbeten të pashfrytëzuara. Dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave krijon mundësi për zhvillim ekonomik, për mbështetjen e iniciativave lokale, si dhe për rritjen e të hyrave vetanake të komunës, të cilat më pas kthehen në shërbime më të mira për qytetarët tanë. Miratimi i këtij vendimi sot i hap rrugë planifikimit me kohë për vitin 2026, dhe siguron një proces të rregullt të barabartë dhe transparent për të gjithë të interesuarit. Është detyrë e jona që të garantojmë se çdo pronë do të shfrytëzohet në mënyrë të ligjshme, efikase dhe në përputhje me interesin publik. Prandaj, ju ftoj sot ta mbështesim këtë vendim dhe të kontribojmë së bashku në menaxhimin e drejtë dhe të qëndrueshëm të pronës komunale të kryeqytetit. Ju faleminderit!

**Kryesuesi:-** faleminderit, znj. Rafuna! Nga radhët e PDK-së, kush deshiron ta marrë fjalën? Leutrim Retkoceri ka kërkuar fjalën.

**Leutrim Retkoceri:-** përshëndetje, kryesues, përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të Kuvendit dhe ju ekzekutiv! Seanca që po e mbajmë sot dhe pika për publikim të listës së pronave të paluajshme të Komunës së Prishtinës është një nga pikat kyçe të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajshme të komunës, e cila kërkohet pikërisht në nenin 13, i cili specifikon edhe vitin dhe datën se deri më 30 dhjetor duhet të bëhet publikimi i pronave të paluajshme të Komunës së Prishtinës. Uroj që lista të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara me ligj dhe të gjitha dhëniet e pronave të jenë në zhvillim ekonomik të komunës dhe të bazuara mirë në interesin publik arsyeshmërinë tjetër po besoj që të dhënat që i kërkon ligji, po besoj që Drejtoria e Pronës i ka të përmbajtura dhe shpresoj që kjo të jetë në dobi të kryeqytetit. Faleminderit!

**Kryesuesi:-** faleminderit, z. Retkoceri! Nga Levizia Vendvendosje, kush deshiron fjalën? Nora Kelmendi ka kërkuar fjalën.

**Nora Kelmendi:-** faleminderit shumë! Falemnderit! I nderuar kryesues, kryetar, kolegë asambleistë, përfaqësues të Administratës Komunale, media dhe qytetarë të Prishtinës. Fillimisht ju falenderoj për dërgimin e listës së veçant të pronave komunale, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim për vitin e ardhshëm. Sot po e marr fjalën, jo për të bllokuar procesin, jo për të krijuar tensione politike, por për të mbrojtur ligjshmërinë, transparencën dhe përgjegjesinë institucionale, të cilat, siç e dini, janë themeli i funksionimit të çdo pushteti lokal demokratik. Fillimisht dua të bëj të qartë se Kuvendi Komunal nuk është organ formal, i cili thjesht vulos vendimet e ekzekutivit, por është organ më i lartë përfaqësues i qytetarëve në nivel lokal. Ky organ ka për detyrë që të ushtroj kontroll, mbikqyrje dhe vendimmarrje të informuar. Kjo përgjegjësi nuk është opsionale, por është përgjegjësi e cila është e përcaktuar me ligj. Sot, para nesh kemi një listë të pronave komunale, të cilat planifikohen për dhënien në shfrytëzim në vitin pasues. Siç po shihet këtu, problemi nuk është ideja e shfrytëzimit të pronës komunale, por problemi është tek mënyra, procedurat dhe mungesa e dokumentacionit të domosdoshëm ligjor. Në dokumentacionin e dërguar nga Ekzekutivi përmes postës elektronike mungonë lista e përgjithshme e pronave të paluajtshme të komunës, e cila sipas ligjit duhet të na dërgohet nga kryetari për miratim paraprakë nga Kuvendi Komunal. Ne këtu para vetës kemi vetëm një listë të veçantë, e cila në vetvete është e mangët. Dua t'ju rikujtoj qartë kornizën ligjore, sepse këtu nuk po flasim për interpretime politike, por për një detyrim ligjor. Ligji numër 06 L 092 për dhënien në shfrytëzim dhe kombimin e pronës së paluajtshme në Nenin 13 e përcakton qartë se komuna është e obliguar të publikojë listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme, pra listën e përgjithshme si dhe listën e veçantë të pronave që planifikon të jepen në shfrytëzim për vitin pasues vijues, më së voni deri me 31 dhjetor duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik. Po ashtu, i njëjti nen e përcakton qartë se lista e pronave për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbajë të dhënat kadastrale, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore të shfrytëzimit. Bazuar në këtë që thashë më lart, konstatohet se dokumentacioni i dorëzuar nuk është në përputhje me kërkesat ligjore, pasi që ne kemi vetëm listën e veçantë dhe nuk e kemi listën e përgjithshme të pronave komunale, si dhe mungojnë disa nga të dhënat e detyrueshme të



përcaktuara me ligj. Në qoftë se shikoni me vëmendje listën e bashkangjitur në Excel me emrin Lista e veçantë, do të shihni se gjithashtu keni cituar edhe përshkruar edhe nenet e gabuara, me të cilat nuk po çuditëm fare, sepse edhe pas katër viteve ju ende bëni gabime të tilla amatereske. Nenet e caktuara dhe të cilat i keni përmendur janë neni 21 i Ligjit 06 L 092, i cili fare nuk ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Nuk ka të bëjë me listën e veçantë, por ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të pronave. Me siguri ju është ngatërruar fjala dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme me raste të veçanta është ngatërruar me fjalën listë e veçantë. Pra, ju nuk jeni duke dhënë në shfrytëzim prona të paluajtshme tani, por jeni duke aprovuar listën e pronave të paluajtshme, të cilat do t'i jepni në shfrytëzim vitin e ardhshëm. Pra, ju këtu duhet të vendosni Nenin 13 të lartshënuar nga po i njëjti ligj dhe ta hiqni Nenin 21. Gjithashtu në po atë një dokument, pra listën e Excel, të cilin e keni dorëzuar tek ne, i keni cituar gabimisht edhe disa nenet e tjera. Neni 24. Neni 25 me paragraf 3 dhe 3.3 të Rregullores nr. 09 2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Në vend të këtyre neneve gjithashtu duhet të vendosni Nenin 6, i cili përcakton procedurat paraprake të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në paragraf 1, 2, 3 dhe 4. Ju kisha lutur kryetar dhe drejtor, t'i përmirësoni këto gabime. Bazuar në këto të dhëna dhe të gjetura, shihet qartë se lista e dorëzuar tek ne nuk i përmbush kriteret themelore të përcaktuara me kornizë ligjore. Kjo listë nuk përmban gjithashtu certifikatat e pronës dhe kopjet e planit për parcelat e listuara. Në këtë listë i kemi 5.288 parcela kadastrale, të cilat janë të shpërndara në zona të ndryshme kadastrale të kryeqytetit. Këtu lind një pyetje thelbësore, që ne si Kuvend nuk mund ta anashkalojmë. A pritni ju që ne si asambleistë t'i votojmë për mbi 5000 parcela komunale, pa pasur asnjë dokument zyrtar që dëshmon pronësinë? A mund të ne si asambleistë të marrim një vendim të tillë, kur nuk kemi në tavolinë dokumentacionin bazë? A mund të votojmë pro, kur nuk e dimë saksisht se për cilat prona bëhet fjalë? Cili është statusi i ca i pronave, statusi juridik dhe a është realisht a kem të bëjmë me prona komunale? Të gjithë ne këtu e dimë se si funksionon sistemi kadastral në Republikën e Kosovës. E dimë që ka raste të shumë kontesteve pronësore, mbivendosjeve, gabimeve historike dhe proceseve të papërfunduara. Prandaj, kërkesa që në dokumentacion t'i kemi certifikatat e pronës dhe kopjet e planit nuk është kërkesë politike, por është masë mbrojtëse ligjore për Kuvendin dhe për interesin publik. Dua të

jam e qartë. Ne nuk mundemi, dhe nuk mund të votojmë diçka symbyllur. Dhe vendimi i tillë jo vetëm që është i papërgjegjshëm politikisht, por potencialisht është edhe i paligjshëm. Kuvendi Komunal nuk mund të vijë përballë aktit të kryer dhe ne këtu nuk jemi për të legjitimuar mungesën e dokumentacionit, por jemi këtu për ta kërkuar atë. Kryetari i nderuar, pozita juaj si kryetar i Kryeqytetit është përgjegjësi e madhe. Ju jeni zgjedhur nga qytetarët për t'i shërbyer atyre, jo vetëm për t'i vënë përballë vendimeve të paqarta dhe procedurave të paplota. Transparenca dhe ligjshmëria duhet të jenë standard, nuk duhet të jenë përjashtim. Askush këtu prej neve nuk kërkon të bllokojë zhvillimin ekonomik apo shfrytëzimin e pronës komunale. Përkundrazi, ne po kërkojmë që të kemi procese në mënyrë të rregullta, procese të dokumentuara dhe të mbrojtura ligjërisht, në mënyrë që nesër as Kuvendi Komunal, as Komuna dhe as qytetarët të mos përballen me pasoja juridike. Prandaj, kërkesa jonë është e qartë dhe e arsyeshme. Të plotësoni dokumentacionin, të dorëzoni listën e përgjithshme të pronave komunale.

T'i bashkangjiten edhe certifikatat e pronës dhe kopjet e planit për parcelat e listuara dhe pas kësaj Kuvendi Komunal të procedojë me shqyrtim dhe vendimmarrje. Kryetar i dashur këto kërkesa nuk mund të quhen pengesa apo qasje destruktive, por thjesht janë kërkesa të adresuara për respektim të ligjit. Ju nuk mund të kërkonit nga ky Kuvend dhe nga ne që të jemi dekor procedural me vendime të gatshme, ndërkohë që dokumentacioni mungon. Kuvendi Komunal nuk mund të jetë zyrë formale që vetëm të vulos atë që sjell ekzekutivi. Por, Kuvendi është një institucion kontrolli dhe përgjegjësi politike. Kërkesa juaj që të votohet një listë me mbi 5000 parcela pa certifikatat e pronës dhe kopje të planit, nuk është vetëm neglizhencë administrative, por është shkelje serioze e parimit të transparencës. Askush këtu nuk ka mandat nga qytetarët për të dhënë vota symbyllur, aq më pak për të marrë përgjegjësi ligjore për dështimet e ekzekutivit. Në qoftë se ekzekutivi mendon se Kuvendi duhet të besojë verbërisht, atëherë na kërkohet të heqim dorë nga roli ynë kushtetues si përfaqësues të qytetarëve. Kjo me siguri që nuk do të ndodhë. Ne jemi këtu për tu mashtruar me lista të paplota dhe me procedura të improvizuara. Pra, këtë nuk mund ta bëjmë. Prandaj, kryetar përgjegjësi është e juaja ose e sillni dokumentacionin e plotë dhe veproni në përputhje me ligjin ose merrni mbi vete barrën politike dhe morale për çdo pasojë që vjen nga kjo qasje juaj. Kuvendi nuk mund të jetë bashkëfajtor në vendime të paqarta, të nxituara dhe të pambështetura në ligj. Lëvizja Vetëvendosje për vite me radhë

ka ndërtuar diskursin e saj politik mbi ligjshmërinë, transparencën dhe luftën kundër keqpërdorimeve. Roli ynë nuk është të duartrokasim ekzekutivin, por ta mbikëqyrim dhe të mbajmë përgjegjësi. Ne si opozitë nuk do të bëhemi mburoj politike për dështimet e ekzekutivit. Nuk do të votojmë symbyllur dhe nuk do të marrim përgjegjësi për shkelje ligjore dhe për mungesë dokumentacioni. Presioni politik nuk na tremb fare dhe shumica juaj numerike nuk e zëvendëson ligjin. Ne si opozitë do të vazhdojmë të kryejmë rolin tonë kushtetues, duke mbrojtur interesin publik dhe pronën e qytetarëve të Prishtinës. Shpresoj sinqerisht që kjo çështje të reflektohet seriozisht nga ju si ekzekutiv dhe që në vazhdim të kem një bashkëpunim institucional dhe transparencë të plotë. Në këtë mënyrë mund të ndërtojmë besimin institucional dhe të marrim vendime në interes të kryeqytetit. Shpresoj gjithashtu që viti 2026 do jetë vit ku ju do të reflektoni dhe të filloni të punoni për së mbari.

**Kryesuesi:-** faleminderit, znj. Kelmendi! Nga radhët e AKK-së deshën fjalën? Jo. Nga Lidhja e Prishtinës dëshironë fjalën dikush? Betim Abdullahu ka kërkuar fjalën.

**Betim Abdullahu:-** faleminderit i nderuar kryesus, të nderuar kolega asambleistë, i nderuar kryetar. Lidhja për Prishtinën mbështet në parim listën e veçant të pronave të paluajtshme që duhet dhënë në shfrytëzim për vitin 2026.

**Kryesuesi:-** faleminderit z. Abdullahu, nga PSD deshën fjalën. Besa Shahini ka kërkuar fjalën.

**Besa Shahini:-** faleminderit, kryesus! I nderuar kryetar, i nderuar kolegë. Unë dua të ndaj një shqetësim me juve për keqmenaxhimin në përmasat dramatike të pronës publike në Komunën e Prishtinës. Ky shqetësim në fakt e ndajnë edhe Zyra Kombëtare e Auditorit të Kosovës, i cili sivjet në fakt vitin 2025 ka nxjerrë një raport të detajuar për mënyrën se si menaxhohet prona e Komunës së Prishtinës. Ajo në fakt jep edhe shumë rekomandime, të cilat kryetari ka kthyer përgjigje në gusht të këtij vitit se duhet të bëjë një plan veprimi për adresimin e të gjitha këtyre komenteve dhe kjo, me sa e kam kuptu, nuk është dorëzuar ende. Dua të bëj një kërkesë formale këtu që ky plan veprimi të hartohet sa më shpejt dhe të ndahet edhe me neve, sepse është mirë që të shohim se si duhet të adresohet keqmenaxhimi i pronës publike në Komunën e Prishtinës. Dëmi që ka shkaktuar buxhetit të Komunës së Prishtinës vetëm nga disa mostra që ka marrë auditori, ka qenë mbi 200.000 euro. Kjo është për vitin 2023-2024. Kjo është nga disa mosrat, pra vetëm disa nga shumë pronave që janë dhënë me qira. Problemet janë të shumta. E para është që nuk ekziston një

regjistër i përgjithshëm i të gjitha pronave, kështu që është shumë e vështirë për të monitoruar pronat që jepen në shfrytëzim ose me qira. Kështu që ky regjistër duhet të përfundohet sa më parë. Problemi tjetër është që nuk inkasohen të hyrat nga këto qira dhe të ndryshme, të cilat mund të i shihni në raportin e detajuar të auditorit. Unë dua të listoj atëherë 5 kërkesa konkrete, të cilat janë parakusht për të votuar këtë listë që keni dërguar. E para është që dokumentet që keni dërguar nuk e kanë arsyetimin publik sipas ligjit që rregullon dhënien me qira ose shfrytëzimin e pronave publike. Ju duhet të jepni një arsyetim për arsyeshmërinë ekonomike edhe qëllimin. Për çfarë arsyeje po jepen këto prona? Kjo nuk ekziston në dokumentet që keni dërguar edhe kjo është shumë e rëndësishme. E dyta, kryetari është i obliguar që çdo gjashtë muaj të raportojë për pronat që janë dhënë në shfrytëzim. Unë do të doja ta shija një raport të tillë minimalisht për pronat që janë dhënë në shfrytëzim vitin 2025 edhe kjo është shumë e rëndësishme. E tretë, Komuna e Prishtinës nuk e ka rregullorën që i kërkohet për dhënien në shfrytëzim të tokave, të pronave në përgjithësi në periudhë më pak se 1 vit. Ky është një dokument i cili është hartuar në 2024. Është kthyer me komente nga MAPL, por nuk e keni vazhdu tutje si procedurë edhe kjo është e domosdoshme, sepse nuk mund të jepen vitin tjetër pastaj asnjë nga pronat me qira, për shkak se nuk ekziston rregullorja që kërkohet me ligj të bëhet kjo. E katërta, tash më e thash që plani i veprimit për ta adresu komentet auditorit është shumë e rëndësishme që të jetë i gatshëm edhe të, të ndahet edhe me neve. Edhe e pesta, Prishtina e ka një problem shumë serioz me mbrojtjen e pronës publike. Çdo ditë, akoma domethënë zaptohet prona publike. Në lagjen ku jetojnë prindërit e mi në Matiçan, unë vazhdimisht shoh pronë publike, cila del aty një garazh, një autolarje, dhe është e pamundur për ta mbrojtë pronën publike. Nëse refuzoni për t'a ndërtu regjistrin e përgjithshëm që është i nevojshëm, për të ditur se ku janë pronat publike të komunës, edhe ajo të jetë një regjistër publik që të mund ta shohim të gjithë edhe të jemi pjesë e këtij procesi të monitorimi. Kështu që me dokumentet që keni dërgu është e pamundur që të votohet lista, të cilën e keni dërgu, sepse nuk është në përputhje me kërkesat ligjore. Edhe unë kam frikën që do të kontribuoj në keqmenaxhimin e më tutjetshëm të pronës publike në Komunën e Prishtinës, faleminderit.

**Kryesuesi:** - faleminderit, znj. Shahini! Nga Nisma nuk dëshiron fjalën. Lista Guxo? Jeton Mehmetaj e ka fjalën.

**Jeton Mehmeti:** - faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, që të mos përsëris fjalët e para folësve të mi shihet qarë që nuk kanë ardh të plotësuar si dosje dhe ka mungesë kjo dosje për votim. Shihet qartë që ne nuk mund të dimë sakt kjo listë e pronave a janë pronat e komunës të regjistruara si pronë të komunës, a kanë konteste ligjore, a ka konteste të tjera pronësore. Pra, ligjërisht ne nuk mund të vërtetojmë edhe të konstatojmë se kjo listë është e plotësuar tamam siç duhet sipas kriterëve ligjore. Prandaj edhe unë e mendoj që kjo listë duhet të plotësohet në raport me ligjin dhe të dorëzohet në Kuvend ashtu siç duhet. Pra jam kundër kësaj liste që të votohet.

**Kryesuesi:-** falemnderit, z. Mehmeti! Fjalën e ka kërkuar Gëzim Sveçla .

**Gëzim Sveçla:** - falemnderit, kryesues! Përhëndetje për të gjithë anëtarët të ekzekutivit, të nderuar asamblastë, përfaqësues të mediave, qytetarë të Prishtinës! Sa i përket aspektit ligjor dhe administrativ, i dëgjuam vërejtjet të cilat i bëri kolegeja Nora. Nga praktika e dimë se kur Nora ka bërë vretje për çështje të pronave ashtu ka rezultu edhe në aspektin e ligjshmërisë edhe atë administrativ. Po du pak me e zbritë, narracionin e bisedës për shkak që qytetarët me kuptu çka po ndodh sot. Faktikisht kjo pikë e rendit të ditës është kërkesë ligjore domethënë prona duhet të. Lista e pronave duhet çdo vit të miratohet deri me 31 dhjetor. Nesër është afati i fundit dhe nëse nuk miratohet kjo listë. Në fakt janë dy lista dhe ne sot siç e tha Nora po flasim veç për një listë, listën e përgjithshme, mungon lista e veçantë. Nëse nuk miratohet i bie që Komuna e Prishtinës vitin e ardhshëm nuk mundet me dhënë asnjë pronë në shfrytëzim, duke e ditur që prona publike komunale është një prej burimeve kryesore që mundëson të hyra financiare, po edhe realizim të interesit publik, qoftë në infrastrukturë, qoftë në lëmi tjerë. Kjo nuk është mirë të ndodhë, domethënë nuk është mirë që Komuna e Prishtinës mos mundet vitin e ardhshëm me i dhënë pronat qoftë në këmbim, qoftë në shfrytëzim, qoftë në mënyra tjera që parashihen me ligj. Mirëpo në anën tjetër, me e sjell një listë me 5288 prona në një seancë të jashtëzakonshme dhe me kërkuar prej asamblesë që me e votu të njëjtën, pa kompletim të dokumentacionit paraprak, me të vërtetë nuk është në rregull. Ky është një trajtim, siç kishte me thënë kolegu im, makineri votash. Asamblastët nuk janë makineri votash, nuk mundem me ngrit dorën për me votu prona të cilat as nuk e dimë kush i zotëron, kush është pronari ligjor, as kush i shfrytëzon, as cili është destinimi i tyre. Kjo mund të shërbejë pastaj për shumë veprime tjera të jashtëligjshme. Mund të ketë qytetarë që këto prona tashmë i kanë në shfrytëzim.

Mund të ketë qytetarë që kanë ndërtu këto prona dhe miratimi i një liste të tillë është njëloj shantazhi ndaj tyre. Unë kisha apeluar që kërkesat të cilat u paraqitën nga asamblistët për plotësim të dokumentacionit të bëhen sot, të shpallet pauzë e kësaj seance dhe derisa të dërgohet dokumentacioni i nevojshëm, mos të vazhdojmë. Gjithsesi të vazhdojmë para afatit ligjor në mënyrë që lista të miratohet. Ta kemi të qartë, ne jemi për miratimin e kësaj liste, po lista duhet të jetë ashtu siç kërkohet me ligj. Po du me ua përmend një shembull. Në këtë listë janë shtatëmbëdhjetë parcela në të cilat është ndërtuar një lagje luksoze. Shtatëmbëdhjetë parcelat e “Lagjes Marigona”, të sponsorëve të Kryetarit Rama e të partnerëve të restoranteve në kulmet e ndërtesave janë pjesë e kësaj liste. Kjo është njëfar tentative që të legjitimohet keqpërdorimi i pronës publike. Nëse këto parcela janë pjesë e kësaj liste, duhet pyetur atëherë qysh është leju që të ndërtohet në ato parcela? Qytetarët kanë blerë shtëpi atje, ndërtuesit kanë ndërtuar atje. Po flasim veç për shtatëmbëdhjetë prej 5288. Kush e di çka ka tjetër gjë këtu? Prandaj kërkoj nga ju që ta plotësoni dokumentacionin, kërkoj nga ju që t'i ndani parcelat, cilat janë në pronësi komunale dhe cilat janë të lira për këmbim ose për shfrytëzim apo për çfarëdo qëllimi tjetër që i përdor komuna e që i shërbejnë interesit publik. Mirëpo tendenca që kështu fshehtas ta kalojmë një listë të tillë, veçse na e zbeh një troh shpresë që kemi pasur, do t'i ndërpreni praktikat që i keni pasur gjatë mandatit të kaluar, e cilat janë të përmendura shumë qartë në çdo raport të auditimit. Prandaj, i bëj thirrje edhe kryetarit edhe drejtorit të pronës edhe gjithë ekzekutivit që të reflektojnë dhe që t'i plotësojnë kërkesat të cilat i kemi parashtruar. Lëvizja Vetëvendosje nuk është për bllokim. Lëvizja Vetëvendosje miraton lista ashtu sipas ligjit dhe sipas kritereve ligjore. Falemnderit.

**Kryesuesi:** - falemnderit, z. Sveçla. Feim Osmani e ka kërkuar fjalën.

**Feim Osmani:** - falemnderit, kryesues! Kjo seancë e sotme për mua, në mënyrën qysh është thirrur, është demantim i qëndrimit tuaj në mbrojtje të deputetëve të partive tuaja, kur 6 javë më parë nuk i votuan Kuvendin e Kosovës tri pika të jetë-rëndësishme për vendin, buxhetin e shtetit, buxhetin e Komunës së Prishtinës dhe marrëveshjet ndërkombëtare me vlerë financiare një miliard euro. Preteksti ishte i njëjtë edhe sot edhe atëherë, se nuk ishin informuar institucionet nga zgjedhjet e 9 shkurtit. A është pra Kuvendi i Prishtinës sot në të njëjtën situatë? Sigurisht se po. A ka drejtorë të emëruar sot të dalë si rezultat i zgjedhjeve lokale të para një muaj? Sigurisht që jo. A i ka të miratuar Kuvendi i Prishtinës sot komitetet

e domosdoshme, së paku ato të përhershme e së paku atë më të rëndësishmin, Komitetin për Politikë e Financa? Sigurisht që jo. A është e njëjta situatë sot, veçse dallojnë protagonistët? Po, natyrisht. Pra në këtë rast, seanca e thirrur për sot është e pakuptimtë në rend të parë, e po ashtu edhe me qëllim për të venduar nën presion të panevojshëm të gjithë anëtarët e Kuvendit, sidomos ata që brengosen me të vërtetë për mënyrën se si trajtohen çështjet që janë të rëndësishme për kryeqytetin, natyrisht, edhe për banorët e tij. Në fakt, kjo listë që është propozuar sot nuk është fare listë e veçantë, por është një listë e përgjithshme të cilës nuk i është hequr asnjë pronë, pa marrë parasysh statusin e saj. Nuk mund ta kuptoj në asnjë rrethanë se si ka mundësi që dikush nga Drejtoria e Pronave të bartë në Excel të gjitha pronat komunale pa përjashtim e që në numër, nëse janë komunale, e që në numër janë plot pesë mijë e tetë qind e katërdhjetë e një sosh dhe t'i dërgojë për miratim si listë të pronave për shfrytëzim në vitin 2026, duke mos ofruar asnjë informatë tjetër, domethënëse që ka të bëjë me gjendjen e pronës, qëllimin e shfrytëzimit, fletën poseduese dhe me dokumentacionin tjetër të nevojshëm. S'i ka mundësi, po ju drejtohem ju të nderuar asamblistë, të votojmë sot në favor të kësaj pike, duke qenë të vetëdijshëm se mbi 80 % e këtyre pronave janë në shfrytëzim tashmë për kohë të gjatë, disa me leje e vendime e disa pa to fare. Madje në shumicën nga to ka edhe ndërtime, të cilat në periudhat e ndryshme janë lejuar po nga kryetari i Prishtinës, të ardhur nga subjekti politik, të cilin e përfaqësoni sot shumë nga ju, të nderuar asamblistë, pra nga LDK-ja. Në shumë nga këto prona ose janë dhënë leje të ndryshme për shfrytëzim ose janë mbyllur sytë dhe janë lejuar ndërtime edhe pa leje. Po bëhen shtatë javë që kanë përfunduar zgjedhjet dhe një muaj që është konstituuar Kuvendi i Komunës së Prishtinës dhe kësaj keni pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur siç i ka hije një institucioni serioz, siç është Kuvendi i kryeqytetit. Dokumentacionin e nevojshëm dhe për të seleksionuar pronat, duke iu bashkëngjitur edhe fleta poseduese e kopjet e planet, bashkë me qëllimin e shfrytëzimit të secilës prej tyre. Dhe ne sot do të votonim pa mëdyshje. Por natyrisht ju nuk e keni kryer punën tuaj, siç ju obligon ligji dhe Rregullorja e Kuvendit. Dhe nesër së pari do të na akuzoni ne asamblistët, pse po e kundërshtojmë një çështje që është bukur e rëndësishme për kryeqytetin, me arsyetimin se është afati i fundit për ta miratuar ose do të mbetemi sikurse vitin e kaluar, pa listë të veçantë të pronave për shfrytëzim edhe për vitin 2026, sikurse që metën vitin e kaluar, ngase u soll po ashtu sikurse sot ditën e fundit dhe në njëjtën

formë siç e kini sjellur sot. Pra pse nuk e sollët më herët?. Më pastaj do të akuzoni edhe ministrinë e linjës , kur ta vlerësoj negativisht aspektin ligjor dhe procedural të vendimit të Kuvendit. Sot në fakt më shumë do të habitesha nëse do të votohej kjo pikë se me çfarë arsytimi do ta votojnë ata asamblastë që nuk e votuan vitin e kaluar të njëjtën listë, të sjellur në të njëjtën mënyrë. Kur e patën sinqerisht sot, nëse votojnë kështu siç është. E natyrisht është në të njëjtën listë sikur e vitit kaluar. Apo atëherë që e kundërshtuat si të parregullt? Pra, pyetje për gjitha asamblastët e legjislaturës së kaluar që kishin vërejtje serioze për të, e në veçanti për ata të PDK-së. E kam parë për këto katër vite sa jam anëtar i këtij kuvendi, se kur e do pushtetin me çdo kusht, parimet bëhen rob të pushtetit. Mirëpo të nderuar anëtarë të Kuvendit, së paku një ndershmëri minimale duhet ta shprehim me fjalë e t'i qëndrojmë besnikë edhe me vepra në çdo rast kur abuzohet në këtë formë me pozitën tonë si anëtarë të Kuvendit, sikurse sot. Kjo listë e pronave, kështu si është sjellur për votim, është dhunim i vullnetit të asamblastëve dhe vënie para aktit të kryer, me paramendim. E natyrisht pastaj qëllimi është i nënkuptuar. Ju ftoj, z. Kryesus, po e përsëris kërkesën e asamblastit të listës Vetëvendosje, që të kërkon pauzë për atë kohë sa do të ishte e mjaftueshme për të korrigjuar listat dhe që ta sjellni para nesh një të dytë vetëm me pronat që janë të lira dhe parapara për shfrytëzim bashkë me dokumentacionin përcjellës. Pra ta sjellni një listë të dytë për votim, ashtu siç e parasheh ligji bashkë me dokumentacionin përcjellës, dhe siç e parasheh rregullorja e Kuvendit, duke na dhënë neve si të zgjedhur të Kryeqytetit kohë të mjaftueshme t'i analizojmë pronat një nga një dhe të votojmë pastaj me bindjet plot se po veprojmë në interes të qytetarëve tonë, ndërsa e kundërta e kësaj është dhunimi i demokracisë dhe abuzim me numrat. Falemnderit.

**Kryesuesi:** - falemnderit, z. Osmani! Fjalën e ka kërkuar Egzon Azemi.

**Egzon Azemi:** - atëherë, falemnderit shumë. Qysh këtu të gjithë e dimë edhe besoj të gjithë pajtohemi. Prishtina është një nga qytetet me më së paku prona publike në pronësi të saj. Rrjedhimisht tema të tilla sinqerisht është dashtë me qenë, diskutime të mirëfillta edhe pa anime, pa inate politike, po për të mirën e vetme të një qyteti që fatkeqësisht posedon jashtëzakonisht shumë pak prona publike. Por çka ka ndodhur gjatë gjithë mandatit kalim dhe çka po vazhdon me ndodhur fatkeqësisht ende është që pikërisht për temat më të rëndësishme, për prona që kanë vlerë milionëshe e miliarda euro, tentojnë me u bë krejtësisht pa diskutim. Tentojnë u bë krejtësisht shpejt e shpejt. E madje, madje, pikërisht



në këto dy drejtori që merren me çështjen e rëndësisë kyçe për kryeqytetin dhe për secilin qytet, normalisht, krijohen pazare, shkarkohen drejtorët për arsye që nuk publikohen, emërohen të tjerë. Ka kritika edhe mes atyre personave dhe ka dëshmi që ka pasur presion nga grupe të caktuara për miratimin e pronave të caktuara. Sinqerisht është e dhimbshme. Fatmirësisht që ka ende njerëz të mirë, gjithashtu subjekte politike që reagojnë dhe nuk lejojnë me u keqpërdor prona në këtë mënyrë dhe jam i bindur që sidomos grupi i LDK-së e di për kend po flas. Prandaj, sinqerisht prap ju lus që kur t'i shohim këto shkelje që po ndodhin me pronat në Prishtinë, të reagojmë, sepse është vendi ynë ky tek e fundit. Zoti kryetar, nuk keni apliku në projektin e thirrjen e Ministrisë për t'i dhënë pronat e qytetit tonë për me u ndërtuar banesat për çiftet e reja. Banesat me çmim të përballueshëm kanë apliku kolegë tu nga partia, Lidhja Demokratike e Kosovës. Ka apliku kryetari i Istogut e ka fitu, ka apliku kryetari i Komunës së Ferizajt e ka fitu, kryetari i Komunës së Kamenicës e ka fitu. Pra, niveli qendror ka dëshmu që nuk ka për qëllim bllokadën, kur komunat janë të interesime me i zhvillu qytetit. Këta kryetarë bashkëpartiakë e tu që kanë apliku, kanë fituar pa balotazh në komunat e tyre. Qasja juaj që e keni pas kryetar, ju ka bërë kryetarin me më së paku vota në rundin e parë të zgjedhjeve. Pra, qytetarët po i vërejnë se kush realisht po bën këso dallime. Prandaj është thirrja edhe për ty, përveç ndryshimeve që i përmenda edhe më herët në këto drejtori kyçe që kanë ndodh pa arsyetime. Ne e shohim që këto drejtori janë bërë pikërisht drejtoritë përmes të cilave po bëhen koalicionet, sepse pikërisht aty po bëhen edhe pazaret. Frika ime më e madhe është që grupet e interesit që i përmendi edhe Giza, na e kanë marrë kryetarin në shfrytëzim e masandej po e marrin cilëndo pronë në shfrytëzim. Dëshmoje kryetar që nuk të kanë marrë në shfrytëzim këto grupe, e ke një mandat plot. Keni pas mbështetjen tonë në secilën pikë që është në interes të Prishtinës. Po e them hapur, sfidona, prapë po them, nuk ke me heq as për numra. Keni me pas edhe mbështetjen e secilit prej neve në Kuvend. Po dëshmoje që nuk të kanë marrë në shfrytëzim këto grupe të interesit edhe që vendimet që merren, sidomos ato që kanë të bëjnë me pronat, nuk je pjesë e tyre apo vegël e tyre, sepse unë jam i bindur që nuk je koka e kësaj skeme kriminale. Por të lutem dëshmoje që nuk je as dora përmes së cilës mundësohet, Prishtina me u bërë qyteti ende më i varfër sesa që është në pronat publike e me hapësirë të përbashkët. Falemnderit.

**Kryesuesi:** - falemnderit z. Azemi. Sokol Havolli ka kërkuar fjalën.

**Sokol Havolli:** - falemnderit kryesues. Ndoshta më tepër po jepet kontekst i gabuar, prej opozitës kësaj çështje, për faktin që publikimi i kësaj liste praktikisht shërben për informim të qytetarëve, se cilat nga pronat janë në dispozicion prej anës së komunës për shfrytëzim. Dhe se procedurat e kërkojnë që secila nga këto çështje të vijë të trajtohet përsëri në Kuvendin Komunal. Kështu që vendimmarrja natyrisht se do të rikthehet në Kuvendin Komunal edhe është absolutisht jo e singertë ndaj qytetarëve që të akuzohet edhe kryetari edhe Kuvendi Komunal, në kontekstin që kjo është një makineri, e votimit. Nuk është makineri e votimit. Është publikim i listës dhe pastaj në bazë të interesit të zhvillimit ekonomik të kryeqytetit, të zhvillimit social, të zhvillimeve kulturore të ndryshme, palët e ndryshme shprehin interesat e tyre dhe aplikojnë konform procedurave për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, çfarëdo qofshin ato, dhe ato aktivitete cilatdo qofshin ato, do të vijnë përsëri këtu, dhe përsëri do të vendosen për votim dhe do të merret vendimmarrja përfundimtare. Kështu që, është e gabueshme të thuhet që ka pas lëvizje të ndryshme lidhur me këto çështje. Madje edhe të përmendet emri i Lidhjes Demokratike të Kosovës nga kolegët. Kështu që, kjo është ajo çka dashta që ta them, që kemi të bëjmë me publikim të listës, e cila do të shërbejë si informacion për çdo palë në Kosovë. Falemnderit!

**Kryesuesi:** - falemnderit, z. Havolli, drejtori i pronës e ka kërkuar fjalën.

**Brahim Mehmetaj:** - më pëlqeu fjala e kuvendares nga vetëvendosja e nderuara Nora që thotë, këtu politikë nuk ka. Edhe unë uroj që këtu mos ketë politikë, sepse gjithmonë sa herë që politika ka pas dorë në vendime ose ka pasur dorë në diskutime të asamblesë, gjithmonë ka bërë dëm. Sot është fjala për një listë të pronave komunale edhe unë ju them që ne i kemi përfunduar detyrat, ashtu siç e parashohin ligjet në fuqi, ku Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale thotë qartë që duhet të publikohet lista e përgjithshme e pronave komunale para datës 31 dhjetor dhe ne e kemi bërë atë publikim. Dhe ai publikim është në web-faqen komunale edhe sot, pastaj thotë, është obligim që të përgatitet dhe të sjellet për votim në Kuvendin e Komunës lista e veçantë me pronat komunale. Çka kemi bërë ne? E kemi përgatit listën e veçantë duke u bazuar në gjithë ato kritere që i parasheh ligji. Dhe ju e keni në email listën ku definohet. Po ja u lexoj shkurt. Për shembull, është numri i parcelës, është sipërfaqja me metër katror, është emri i pronarit, ku pronar është Komuna e Prishtinës, është zona katastrale dhe dokumenti që sipas planifikimit hapësinor, ne i kemi printu komplet listat, fletat poseduese dhe kopjet e planit

edhe i kemi dërgu në zyrën e Kuvendit, e cila ka qenë dashtë me i shpërnda. Nuk e di a i ka shpërndarë. Nuk jam i sigurt. Po po ju them që si proces ne e kemi përmbyll tamam ashtu siç e parasheh ligji, përveç që e kemi një dallim. Ku i kemi fut? E kemi bërë filtrimin, filtrimin e pronave. Nuk është lista e përgjithshme njësoj sikur lista e veçantë. Lista e përgjithshme e pronave komunale dallon prej kësaj edhe në numër. Ne e kemi bërë një filtrim, ku mund të ketë gabime teknike. Nuk e përjashtoj atë mundësi që mund të prodhojë, sepse ka pas shumë numra, shumë prona edhe ke mundur me bërë ndonjë gabim teknik. Po kryesisht jemi bazuar në regjistër katastral edhe me fleta poseduese, të cilat janë në email-at e Zyrës së Kuvendit, janë të gjitha, fleta poseduese, kopja e planit. Çka është çështja tjetër? Ky, sot është vetëm hap i parë i aprovimit, por shkak që ashtu e parasheh ligji. Hapat tjerë janë pasues, së pari pas këtij, pas vendimit ku sot do të aprovohet kjo listë. Uroj që të aprovohet. Atëherë shkon për ligjshmëri te Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal edhe kthehet prapa. Pastaj bëhet shpallja publike, shpallja zyrtare, mandej bëhet, formohet komisioni vlerësues prej Kuvendit Komunal, i cili komision përbëhet prej pesë anëtarëve, ku dy anëtarë i propozoni ju, dy ekzekutivi edhe një prej shoqërisë civile. Bëhet shpallja publike dhe sigurohen, pastaj njoftohen qytetarët. Është shumë transparent ky proces ku gjitha listat janë dhe të gjithë të interesuarit do të marrin pjesë, ku vlen parimi i konkurrueshmërisë. Çështja tjetër kryesore është që ne sot nuk duhet ta humbim afatin, sepse kemi humb shumë vite dhe asnjëherë nuk është zhvilluar asnjë procedurë e kësaj qysh po pretendojmë ne e rregullt ku duhet të jetë transparencë në nivel edhe konkurrueshmëria, ku pastaj përmes kësaj do të kemi zhvillim ekonomik, rritje të vendeve të punës, do të sigurojmë edhe buxhet shtesë për komunën, për kryeqytetin e Prishtinës, duke rritë tatimet në pronë dhe inkasimin e mjeteve nga qiraja. Unë mendoj që ky nuk është proces i dëmshëm, as nuk është procesi i cili ndikon politikisht, sepse falë Zotit nuk ka votë tash është kryer çështja e votës, është çështja e interesit qytetar. Edhe unë ju thërras të gjithëve që ta votojmë interesin qytetar, filtrimi i këtyre pronave dhe ato gabime teknike të cilat mund të ekzistojnë brenda listës do të bëhen në proceset vijuese që kanë me ndodh në të ardhmen, si dhe dora e Kuvendit është gjithmonë aty edhe nuk ka me mund asnjë njeri me manipuluar me këtë çështje e as me keqpërdor. Kështu që falemnderit për mirëkuptim. Nuk po du me hy në tema tjera, e ka kuptu edhe Feimi çka pretendoj edhe Egzonin e

falënderoj për kontributin. Po megjithatë unë kërkoj për interes të qytetarëve që kjo sot të votohet. Falemnderit.

**Kryesuesi:** - falemnderit z. Ibrahim. Zoti Sveçla dy minuta i ke. Edhe ju kisha lut të tjerëve pas z. Sveçla shfrytëzoni të drejtën që shefat e grupeve i kanë nga dhjetë minuta, dy tjerët i kanë nga pesë minuta. Mirëpo fjala tash për juve Norë, ju kisha lut, nuk mund t'i shfrytëzoni njëherë 10 tani 5, për ata është shefi i grupit dhe i ka dhjetë minuta. Kjo vlen për secilin grup. I kryen dhjetë minutat, më nuk ka të drejtë me marr fjalën. Zoti Sveçla, dy minuta i ke.

**Gëzim Sveçla:** - falemnderit. E para është pak e dëmshme që, diskutimi mbi një temë kaq të rëndësishme siç janë pronat komunale me reduktu në minutazhë ose në sekonda që të jep kryesuesi dhe regjia. E dyta, drejtori sapo e legjitimoi plotësisht atë që e ngriti si shqetësim Nora. Drejtori tha që i kemi dërgu certifikatat e pronës e na s'e kemi pranë. I bjen që s'është i plotë dokumentacioni. Si pasojë e kësaj, ky vendim që e merr sot Kuvendi Komunal kur të shkon për ligjshmëri në MAPL, do të shpallet i paligjshëm, sepse dokumentacioni nuk është i kompletuar. Rrjedhimisht, Komuna e Prishtinës e humb një afat i cili është afat ligjor, 31 dhjetori i çdo viti. Pra, argumenti i ngritur nga Nora për mungesë të dokumentacionit qëndron, plotësisht e kemi të qartë e kemi edhe parasysh sepse është ligji ai që e normon këtë çështje, që ky është vetëm hapi i parë, sepse pastaj secila pronë vjen në Kuvend. Por kjo nuk e legjitimon idenë që duhesh ti në hapin e parë me shkel ligjin, sepse pastaj kemi pas një mundësi të dytë me e korrigju këtë. Është e panevojshme. Edhe nuk e morëm përgjigjen në shumë pyetje që i ngritëm. Është rast konkret, shtatëmbëdhjetë parcela, cilat janë pjesë e listës që na e keni sjellë në Kuvend Komunal. Në këto parcela është e ndërtuar një lagje luksoze, "Marigona Hill". Qytetarët kanë blerë prona në këto parcela, kanë blerë shtëpi. A na tregoni pse këto pronë, këto parcela janë pjesë e kësaj liste? Dhe e dyta, a na tregoni qysh ka mundësi, që është ndërtu në ato parcela, nëse këto janë të gatshme për dhënien në shfrytëzim? Unë e kam parasysh që kjo është një listë e gjërë, po duhet të dimë cila prej këtyre është e gatshme për më dhënë në shfrytëzim ose në këmbim, cila është e uzurpume, cila veç është dhënë me një kontratë qoftë me komunën qoftë çfarëdo kontrate tjetër. Drejtor, shumë mirë që e përmende atë komisionin, për katër vjet asnjëherë Komuna e Prishtinës nuk e ka formuar atë komision, i cili e bën vlerësimin e pronave, cilat pastaj do të jepen për këmbim ose për shfrytëzim. Prandaj, duke

i ditë praktikat që kanë ndodh deri tani, për besë e kemi të pamundur që ta votojmë një listë të tillë, nëse e njëjta nuk korrigjohet dhe nëse nuk marrim përgjigje në kërkesat të cilat i parashtruam.

**Kryesuesi:** - falemnderit z. Sveçla! A dëshiron dikush fjalën?. Feim një minutë e ke.

**Feim Osmani:** - po, mos na kufizohet kështu kryesues, një minutë se është e pamundur. Tema është jashtëzakonisht e rëndësishme. Unë drejtor nuk po them që nuk do të vijë në Kuvend. Çështja është që këtu janë pesë mijë e tetëqind e dyzet e një prona. Dhe me aq informata sa kemi është e pamundur që ne t'i analizojmë cila është dhe çfarë statusi ka. Nuk e dimë cila është e lirë, cila është e shfrytëzuar tashmë dhe unë po të betohem se një pjesë që i di si terren edhe që i kam pa janë në shfrytëzim, dhe ato janë me dokumentacion, kanë ndërtime, e çështje të ndryshme. Për këtë arsye po e them që kjo listë nuk është e veçantë, ashtu siç kërkohet në rend të ditës, por është listë shumë e përgjithshme, nëse nuk janë gjitha pronat e futura në excel aty, pa u nda asnjë. Kështu që do duhej të definoheshin. Unë besoj që ka mundësi, nëse ka vullnet sot me u trajtu kjo çështje në mënyrë meritore dhe me u votuar ashtu qysh i takon, një Kuvendi të Kryeqytetit.

**Kryesuesi:** - falemnderit, z. Osmani!. Z. Azemi, një minutë.

**Egzon Azemi:** - e para, kryesues tamam veç sa ma vërtetoj ata që e thashë në fjalën e parë, që domethënë tentohet me çdo kusht me kalu në heshtje diskutimet për prona, sa më pak debat. Ne e dimë kryesus që personalisht e privatisht keni shumë prona, por qysh janë të rëndësishme për ty pronat tua, për asamblenë janë të rëndësishme pronat e komunës. E dyta, zoti kryetar, sipas informacioneve, për besë nuk e di ku banon, po një qytetar tash më ka shkruajtur më ka thënë që pyete kryetarin se a banon në një nga lagjet private që iu përmenden, dhe a mundet me qenë konflikt interesi pjesëmarrja në seancën e tillë. Falemnderit!

**Kryesuesi:** - falemnderit z. Azemi. S'di çka u lidhën me pronat e mia, s'ka lidhje hiç ajo, absolut, hiç, s'ka të bëjë me pronat e mia këtu hiç. S'kanë lidhje pronat e mia me këto. Krejt me djerës i kam fitu. Të lutem, a ka dikush tjetër që dëshiron fjalën? Atëherë, lus regjinë të jetë gati për votim të kësaj pike. A ka mundësi edhe njëherë me konstatuar kuorumin se sa jamë prezent? 45. Kemi kuorum. Regjia të jetë gati për votim. Votojmë tash. Falemnderit. Me 31 vota për, 14 kundër, abstenim nuk ka, kalon kjo pikë e rendit të ditës. Nëse nuk keni diçka tjetër, atëherë kolegë të nderuar ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe me

këtë e konstatoj të mbyllur këtë mbledhje të sotme, dhe mirupafshim në mbledhjen e ardhshme. Njëherit ju uroj vitin e ri të gjithëve! Urime festat!.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës,  
mbajtur më 30.12.2025, e cila filloi në orën 11:12.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, (Lidhja për Prishtinën), kryesues i Kuvendit, Bujar Gashi (LDK), Bekim Gashi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Fadil Aliu (LDK), Egzon Pacolli (LDK), Sokol Havolli (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Etnik Mustafa (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Lindita Rexhepi-Osmani (LDK), Rifadije Sopi (LDK), Amir Simnica (LDK), Agron Canolli (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Yll Muriqi (PDK), Granit Geci (PDK), Florian Beka (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fjolla Vukshinaj-Reçica (PDK), Trim Sylja (PDK), Besianë Musmurati (PDK), Mrika Limani Myrtaj (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Jeta Dida-Bujari (LVV), Berita Abazi-Muhadri (LVV), Egzon Azemi (LVV), Feim Osmani (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Nexhmije Gjema (LVV), Lumniqe Mikullovc (LVV), Leonora Shabani-Bajraktari (LVV), Enver Redenica (LVV), Kreshnik Smajlaj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Yll Bogaj (AAK), Betim Abdullahu (Lidhja e Prishtinës), Arbentia Murseli-Haxholli (Lidhja e Prishtinës), Teuta Kadiu-Gjinolli (Lidhja e Prishtinës), Besa Shahini (PSD), Endrit Zabërgja (NISMA), Jeton Mehmeti (GUXO).

**Munguan:** Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Ilirik Musliu (PDK), Plator Gërdovci (PDK), Erblina Tahiraj (AAK), Valbona Ajeti (AAK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, Kryetar i Kryeqytetit, Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Emergjencave, Arben Kqira, UD i drejtorit të Drejtorisë së Administratës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Mobilitetit, Samir Shahini, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Florent Maliqi, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit, Gëzim Kastrati, drejtor i Drejtorisë së Transformimit, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it dhe të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues i Kuvendit. Pas verifikimit të kuorumit të anëtarëve të pranishëm, njoftoi për një ndryshim në përbërje të Kuvendit, pas dorëheqjes së asamblistes Nora Cimili-Gagic, zëvendësohet nga znj. Arbnora Ajeti, e cila bëri betimin solemn në përputhje me ligjin në fuqi.

Kryesusi vazhdoi mbledhjen me këtë

## **Rend dite:**

### **1. Propozim-vendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2026.**

**Brahim Mehmetaj** paraqiti para Kuvendit të Kryeqytetit listën e veçantë të pronave komunale të propozuara për shfrytëzim. Ai theksoi se lista është në harmoni me legjistacionin në fuqi, Strategjinë zhvillimore komunale, si dhe me parimet e transparencës, interesin publik dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pronës publike. Qëllimi kryesor për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale është që të mos mbesin prona të pashfrytëzuara, por të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të kryeqytetit, krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të hyrave të kryeqytetit. Drejtori theksoi se dhënia në shfrytëzim do të bëhet përmes procedurave të hapura dhe transparente. Ai ftoi asamblistët ta shqyrtojnë listën me seriozitet dhe përgjegjësi, të jepen sugjerimet dhe ta mbështesin miratimin e saj që t'u hapin rrugë investimeve të reja në të mirë të kryeqytetit.

**Jeta Rafuna-Hasani** theksoi se miratimi i Vendimit për listën e veçantë të pronave ka një rëndësi të veçantë në krijimin e mundësive të zhvillimit ekonomik, mbështetjen e iniciativave qytetare dhe rritjen e të hyrave vetanake të kryeqytetit, të cilat kthehen në shërbime më të mira për qytetarët. Ajo tha se miratimi i vendimit siguron një proces të rregullt, të barabartë dhe transparent, duke garantuar shfrytëzim të ligjshëm dhe efikas të pronës publike dhe bëri thirrje për miratimin e vendimit.

**Leutrim Retkoceri** u shpreh se publikimi i listës së pronave të paluajtshme të Komunës së Prishtinës është një kërkesë thelbësore ligjore, e paraparë në nenin 13 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, që duhet të realizohet deri më 30 dhjetor. Ai theksoi se lista duhet të përmbajë të gjitha elementet dhe të dhënat e kërkuara me ligj, të jenë të bazuara mirë dhe në funksion të zhvillimit ekonomik dhe interesit publik. Unë besoj se Drejtoria e Pronës i ka përfshirë të gjitha këto të dhëna në dobi të kryeqytetit.

**Nora Kelmendi** tha se qëllimi nuk është bllokimi i proceseve, por mbrojtja e ligjshmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë institucionale. Kuvendi i Komunës nuk është organ formal që vetëm miraton vendime të ekzekutivit, por ka rol ligjor të kontrollit dhe mbikëqyrjes. Kelmendi theksoi se problemi nuk qëndron te dhënia në shfrytëzim e pronës komunale, por te procedurat e gabuara, mungesa e dokumentacionit ligjor. Ekzekutivi ka dorëzuar vetëm listën e veçantë të pronave, pa listën e përgjithshme të pronave komunale, e cila sipas Ligjit nr. 06/L-092, nenit 13, duhet të miratohet paraprakisht nga Kuvendi dhe të publikohet deri më 31 dhjetor të këtij viti. Ajo bëri të ditur se lista e dorëzuar nuk i plotëson kërkesat ligjore, mungojnë të dhënat kadastrale të plota, qëllimi dhe afati i shfrytëzimit, si dhe certifikatat e pronësisë dhe kopjet e planeve për mbi 5,000 parcela kadastrale. Nga ne kërkohet që të votohet për një numër të madh parcelash pa pasur dëshmi të pronësisë dhe pa qartësi mbi statusin juridik, gjë që përbën rrezik ligjor dhe institucional. Nora tha se Vendimi i tillë do të ishte i papërgjegjshëm dhe potencialisht i paligjshëm, andaj kërkoi nga ekzekutivi të plotësohet dokumentacioni sipas ligjit



në fuqi, të dorëzohet lista e përgjithshme e pronave komunale me dokumentet përkatëse, dhe vetëm pas kësaj të procedohet në shqyrtim dhe vendimmarrje.

Ajo deklaroi se nuk do të votojmë pa dokumentacionin e kompletuar dhe nuk do të marrim përgjegjësi për shkelje të mundëshme ligjore, dhe kërkojmë transparencë dhe respektim të ligjit në interes të qytetarëve të Prishtinës.

**Betim Abdullahu** deklaroi se Lidhja për Prishtinën e mbështet në parim listën e veçantë të pronave të paluajtshme që planifikohen të jepen në shfrytëzim për vitin 2026.

**Besa Shahini** ngriti shqetësim për keqmenaxhimin serioz të pronës publike në Komunën e Prishtinës, duke iu referuar raportit të Zyrës Kombëtare të Auditorit, i cili evidenton mungesë të regjistrit të përgjithshëm të pronave, mosarkëtim të të hyrave nga qiratë, ku buxhetit të Komunës i është bërë dëm financiar mbi 200 mijë euro nga disa mostra të audituara. Ajo kërkoj hartimin dhe publikimin në Kuvend të Planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditorit, si dhe përfundimin e regjistrit të përgjithshëm të pronave publike. Si parakusht për votim, ajo kërkoj: arsyetim publik dhe ekonomik për dhënien në shfrytëzim të pronave, raportim gjashtëmuor për pronat e dhëna në shfrytëzim, miratimin e Rregullores për dhënien me qira afatshkurtër, përgatitjen e Planit të veprimit të auditorit dhe masa konkrete për mbrojtjen e pronës publike nga uzurpimet. Ajo theksoi se me dokumentacionin aktual lista nuk është në përputhje me ligjin dhe votimi i saj do të kontribuonte në keqmenaxhim të mëtejshëm të pronës publike.

**Jeton Mehmeti** u shpreh se dosja e sjellë në Kuvend ka mungesë të dokumentacionit dhe nuk dihet ligjshmëria e tyre. Nuk kemi informata se këto prona a janë të regjistruar si prona komunale dhe a kanë konteste ligjore apo pronësore. Ai kërkoj që kjo listë të plotësohet ashtu siç e parasheh legjislacioni në fuqi dhe të silltet në Kuvend për miratim. Duke pasur parasysh këto që u cekën, unë jam kundër votimit të kësaj pikë në formën si është tash.

**Gëzim Sveçla** theksoi se miratimi i listës së pronave komunale është kërkesë ligjore dhe duhet të bëhet deri më 31 dhjetor, përndryshe Komuna e Prishtinës rrezikon të mos mund të japë prona në shfrytëzim apo këmbim gjatë vitit të ardhshëm. Megjithatë, ai vlerësoi se paraqitja e një liste me 5,288 prona në një seancë të jashtëzakonshme, pa dokumentacion të plotë dhe pa listën e veçantë, është e papranueshme dhe në kundërshtim me parimet e transparencës dhe ligjshmërisë. Sveçla tha se asamblistët nuk mund të trajtohen si “makineri votash”. Nuk mund të votohet një listë për prona për të cilat nuk dihet qartë pronësia, shfrytëzimi dhe destinimi. Ai paralajmëroi se një miratim i tillë mund të hapë rrugë për keqpërdorime dhe veprime të jashtëligjshme, duke përfshirë legjitimitimin e ndërtimeve në prona publike. Sveçla përmendi përfshirjen e 17 parcelave të lagjes “Marigona” në listë, duke ngritur dyshime serioze mbi lejimin e ndërtimeve në to dhe mbi tentativën për legjitimitimin e keqpërdorimit të pronës publike. Sveçla kërkoj plotësimin e dokumentacionit, ndarjen e qartë të parcelave sipas statusit ligjor dhe vazhdimin e seancës brenda afatit ligjor, duke theksuar se Lëvizja Vetëvendosje mbështet miratimin e listave vetëm kur ato janë në përputhje të plotë me ligjin.

**Feim Osmani** vlerësoi se seanca e thirrur është e pakuptimtë dhe në kundërshtim me standardet institucionale, duke e krahasuar situatën aktuale të Kuvendit të Komunës me arsyetimet e përdorura më herët në Kuvendin e Kosovës për mosmiratimin e çështjeve madhore shtetërore. Ai theksoi se Kuvendi aktualisht nuk ka të miratuara komitetet e domosdoshme, përfshirë Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe se nuk ekzistojnë ende struktura funksionale që do ta justifikonin një vendimarrje të tillë. Osmani kritikoi ashpër listën e propozuar të pronave, duke theksuar se ajo nuk përbën listë të veçantë sipas ligjit, por një listë të përgjithshme, ku janë përfshirë pa dallim të gjitha pronat komunale, gjithsej 5,841 sosh, pa asnjë dokumentacion shoqërues për statusin juridik, shfrytëzimin, fletët poseduese apo qëllimin e përdorimit. Ai theksoi se mbi 80% e këtyre pronave tashmë janë në shfrytëzim, shpesh edhe me ndërtime të lejuara ose të toleruara pa leje nga qeverisjet e kaluara komunale. Osmani tha se ekzekutivi ka pasur kohë të mjaftueshme pas zgjedhjeve për të përgatitur dokumentacionin e nevojshëm dhe për të sjellë një listë të seleksionuar dhe të ligjshme, por këtë nuk e ka bërë. Ai paralajmëroi se miratimi i kësaj liste në formën aktuale, përbën dhunim të vullnetit të asamblistëve, vendosje para aktit të kryer dhe abuzim me procedurat demokratike. Gjithashtu, kërkoi dhënien e një pauze dhe përgatitjen e një liste të veçantë vetëm me pronat e lira për shfrytëzim, të shoqëruar me dokumentacion të plotë ligjor, duke u dhënë kohë të mjaftueshme asamblistëve për analizë dhe vendimarrje në interes të qytetarëve të Kryeqytetit, ndërsa e kundërta e kësaj është dhunimi i demokracisë.

**Egzon Azemi** tha se Prishtina është një nga qytetet me më së paku prona publike, prandaj vendimet për to duhet të merren me debat serioz dhe pa pazare politike, siç ka ndodhur gjatë mandatit të kaluar por edhe tani. Vendimet për prona me vlerë milionëshe, po tentohen të kalojnë shpejt, pa transparencë, duke u shoqëruar me shkarkime të pashpjeguara drejtorësh dhe presione nga grupe interesi. Ai tha se ka dëshmi për ndërhyrje të tilla, gjë që është e dëmshme për qytetin, por fatmirësisht që ka ende njerëz të mirë, gjithashtu subjekte politike që reagojnë dhe nuk lejojnë me u keqpërdorur prona në këtë mënyrë. Azemi deklaroi se kryetari nuk ka aplikuar në thirrjen e Ministrisë për ndërtimin e banesave të përballueshme për çiftet e reja, ndryshe nga komunat e tjera që kanë përfituar. Ai tha se kjo tregon mungesë vullneti, vizioni dhe qytetarët po e vërejnë këtë qasje. Azemi kërkoi nga kryetari të dëshmojë se nuk është nën ndikimin e grupeve të interesit dhe se vendimet për pronat publike merren në interes të qytetit. Ai theksoi se ka gatishmëri për mbështetje politike për çdo vendim që është në të mirë të Prishtinës, por kërkohet transparencë, përgjegjësi dhe mbrojtje e pronës publike.

**Sokol Havolli** tha se publikimi i listës së pronave komunale ka për qëllim informimin e qytetarëve se cilat prona janë në dispozicion për shfrytëzim dhe nuk përbën vendimarrje përfundimtare. Çdo çështje lidhur me këto prona do të rikthehet për trajtim dhe votim në Kuvendin e Komunës sipas procedurave ligjore. Ai tha se lista shërben vetëm si bazë informuese, ndërsa palë të ndryshme mund të shprehin interes dhe të aplikojnë konform procedurave për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik, social apo kulturor të Kryeqytetit. Prandaj, pretendimet për lëvizje apo pazare politike janë të pabazuara, sepse vendimarrja finale do të merret gjithmonë në Kuvendin e Komunës.

**Brahim Mehmetaj** tha se çështja në shqyrtim ka karakter ligjor dhe teknik dhe nuk duhet të trajtohet si çështje politike. Ne kemi përmbushur obligimet e përcaktuara me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale, përfshirë publikimin e listës së përgjithshme të pronave komunale para afatit ligjor, e cila është e publikuar në faqen zyrtare të Komunës. Po

ashtu, është përgatitur lista e veçantë e pronave komunale për shqyrtim dhe votim në Kuvendin komunal, në përputhje me kriteret ligjore. Mehmetaj tha se lista përmban të dhëna të detajuara, përfshirë numrin e parcelës, sipërfaqen, pronësinë, zonën kadastrale dhe dokumentacionin përkatës të planifikimit hapësinor, i është bashkëngjitur edhe dokumentacioni shoqërues, përfshirë fletët poseduese dhe kopjet e planeve, të cilat janë dorëzuar në Zyrën e Kuvendit. Ai tha se lista e veçantë është rezultat i një filtrimi të pronave dhe mund të përmbajë gabime teknike, të cilat mund të korrigjohen në fazat pasuese. Votimi i sotëm përfaqëson vetëm hapin e parë procedural, pastaj lista dërgohet në MAPL për ligjshmëri, hapet shpallja publike dhe formohet komisioni vlerësues me përfaqësim të Kuvendit, ekzekutivit dhe shoqërisë civile, duke garantuar transparencë dhe konkurrencë. Qëllimi i procesit është respektimi i afateve ligjore, mbrojtja e interesit publik dhe krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik, rritje të punësimit dhe të t[hyrave komunale, prandaj kërkoj që lista të votohet në interes të qytetarëve, me garanci se Kuvendi mbetet mekanizmi kryesor mbikëqyrës dhe se nuk ka hapësirë për keqpërdorim.

**Gëzim Sveçla** tha se po na kufizohet padrejtësisht në kohë diskutimi për pronat komunale, duke cenuar trajtimin serioz të një çështjeje me rëndësi të madhe publike. Ai theksoi se dokumentacioni për pronat nuk është i kompletuar, fakt i konfirmuar edhe nga drejtori, çka e bën vendimin e Kuvendit komunal të cenueshëm ligjërisht dhe të rrezikuar të shpallet i paligjshëm nga MAPL, pastaj kjo do të sillte humbjen e afatit ligjor të 31 dhjetorit për Komunën e Prishtinës. Sveçla theksoi se procedurat parashihen të zhvillohen në faza, por kjo nuk justifikon shkeljen e ligjit në hapin e parë. Ai ngriti shqetësime konkrete për përfshirjen e 17 parcelave ku është ndërtuar lagjja “Marigona Hill” në listën e pronave, duke kërkuar sqarime mbi statusin e tyre dhe mënyrën se si janë ndërtuar nëse konsiderohen të gatshme për dhënie në shfrytëzim apo këmbim. Po ashtu, u kërkuar që të sqarohet statusi i secilës pronë në listë, nëse është e lirë, e uzurpuar, apo e lidhur me kontrata ekzistuese. Sveçla tha se për katër vjet nuk është formuar Komisioni për vlerësimin e pronave komunale, i cili është parakusht ligjor për këto procese, pastaj për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë, mungesës së përgjigjeve dhe mosrespektimit të procedurave ligjore. Ai vlerësoi se lista nuk mund të votohet pa u korrigjuar dhe pa u adresuar të gjitha kërkesat e ngritura.

**Feim Osmani** thekson se tema është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe kërkon debat të mirëfilltë, pa kufizime kohore. Ai shpreh shqetësimin se lista e paraqitur më 5,841 prona është shumë e përgjithshme dhe mungojnë informatat bazë për statusin e tyre, nëse janë të lira apo në shfrytëzim. Sipas tij, disa prona tashmë janë në shfrytëzim dhe kanë dokumentacion, e në disa ka ndërtime ekzistuese. Për këtë arsye, ai vlerëson se pa një analizë të detajuar dhe pa definim të qartë të pronave, Kuvendi nuk mund të marrë vendim të bazuar. Ai tha se, nëse ekziston vullneti, çështja mund të trajtohet në mënyrë meritore dhe të votohet ashtu siç i takon Kuvendit të Kryeqytetit.

**Vendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në Vitin 2026, u miratua më 31 vota për, 14 vota kundër dhe asnjë abstenim.**

**Mbledhja përfundoi në orën 12:05.**

**Procesmbajtësi**  
**Skender Tora**

**Kryesues i Kuvendit**  
**Fehmi Kupina**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d)**, nenit 51, paragrafi 51.1 dhe nenit 52 të Ligjit nr. 03/L- 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të neneve 3, 4, 5 dhe nenit 6, të Udhëzimit administrativ nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve të tjera në komunë, të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d)** dhe të nenit 44, paragrafi 44.1, shkronja **a)** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më ..... 2026, merr këtë

**VENDIM**  
**PËR**  
**FORMIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

**I.** Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si komitet i përhershëm.

**II.** Komiteti për Politikë dhe Financa ka këtë përbërje:

- 1. Fehmi Kupina, kryesues;**
- 2. , anëtar;**
- 3. , anëtar;**
- 4. , anëtar;**
- 5. , anëtar;**
- 6. , anëtar;**
- 7. , anëtar;**
- 8. , anëtar;**
- 9. , anëtar;**
- 10. , anëtar;**
- 11. , anëtar.**

**III.** Komiteti si në pikën I të këtij vendimi, është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren

vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KYEQYTETIT**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Fehmi Kupina**



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d)** e Ligjit nr. 03/L – 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d)** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më .... 2026, merr këtë

**V E N D I M  
P Ë R**

**FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS  
SË KUVENDIT PËR VITIN 2026**

**I.** Miratohet Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

**II.** Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

- 1. Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit,**
- 2. , anëtar,**
- 3. , anëtar,**
- 4. , anëtar,**
- 5. , anëtare,**
- 6. , anëtar,**
- 7. , përfaqësues i ekzekutivit, anëtar,**
- 8. , përfaqësuese e Sektorit për punë të Kuvendit, anëtare,**
- 9. , përfaqësues i Zyrës ligjore, anëtar.**

**III.** Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera - pjesën me kompetencë të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026. Pas hartimit të planit final, grupi punues do ta prezantojë para Kuvendit të Komunës për miratim.

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**

**KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

---

**PROPOZIM**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 14.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 12, paragrafi 2, të Ligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më .2026 mori këtë:

**VENDIM**

- I. **MIRATOHET** bartja e 45 (dyzet e pesë) normave — pozitive nga niveli arsimit të mesëm të lartë në nivelin parafillor dhe fillor mesëm të ulët.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi, 18 (tetëmbëdhjetë) norma-pozita do të barten në nivelin parafillor dhe 27 (njëzet e shtatë) norma- pozita do të barten në nivelin fillor dhe mesëm të ulët.
- m. Bartja e normave — pozitive si në pikën I të këtij propozimi bëhet për shkakë të rritjes dhe tejkalimit të nevojave për staf në nivelin parafillor si rrjedhojë e ndërtimit të I. P “Xixëllonja” dhe aneksit të I. P “Ardhmëria, si dhe planifikimit për hapjen e I. P- së së re në lagjen “Dardania”.
- IV. Për zbatimin e liëtij vendimi kujdesen: Kryetari i Kryeqytetit, Drejtorja e Arsimit si dhe drejtoritë dhe sektoret tjera kompetente.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**

**KRYESUESI I KUVENDIT**

01. nr. \_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_

Fehmi Kupina



Të nderuar, përfaqësues të Asamblesë Komunale,

Ju njoftojmë se Drejtoria e Arsimit kërkon mbështetjen tuaj për miratimin e pikës së rendit të ditës që ka të bëjë me bartjen e pozitave të lira nga niveli i arsimit të mesëm të lartë në nivelin parafillor dhe fillor mesëm të ulët.

Për informimin tuaj të drejtë, Drejtoria e Arsimit e ka të përcaktuar numrin e normave të stafit arsimor për secilin nivel të arsimit parauniversitar. Aktualisht, bazuar në vlerësimin e gjendjes faktike, konstatojmë se kemi tejkalim të normave të lejuara në nivelet parafillor dhe fillor.

Sipas Ligjit për ndarjet buxhetore për vitin 2024, konkretisht paragrafit 2 të nenit 12, theksohet se: "Numri i të punësuarve dhe shuma përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve për paga dhe shtesa nëpër nënprograme mund të përshtaten me vendim të Ministrit, me arsyetim përkatës nga Organizata Buxhetore (OB), duke përjashtuar kufizimet e përcaktuara. Në rastin e OB-ve të nivelit lokal, nevojitet paraprakisht edhe vendimi i Kuvendit Komunal."

Andaj, për të mundësuar bartjen e normave të stafit arsimor nga niveli i arsimit të mesëm të lartë në nivelet parafillor dhe fillor, kërkohet mbështetja dhe miratimi juaj.

Aktualisht, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kemi **53 norma të lira**, ndërsa në nivelet parafillor dhe fillor vlerësojmë se kemi nevojë për bartjen e rreth **45 normave**. Në bazë të analizës së normave për **nivelin parafillor propozojmë 18 norma**, ndërsa për **nivelin fillor dhe mesëm të ulët 27 norma**.

Rritja dhe tejkalimi i nevojave për staf në nivelin parafillor është si pasojë e rritjes së kapaciteteve për fëmijë dhe edukatore, si rezultat i ndërtimit të institucionit të ri parashkollor "Xixëllonja" si dhe ndërtimit të aneksit të kopshtit "Ardhmëria".

Ndërtimi i institucionit "Xixëllonja" ka mundësuar pranimin e 120 fëmijëve të rinj, gjë që ka ndikuar në rritjen e nevojës për staf edukativ. Po ashtu, ndërtimi i aneksit të kopshtit "Ardhmëria" ka rritur kapacitetin edhe për 50 fëmijë të tjerë. Për më tepër, për vitin edukativ 2025-2026 planifikohet hapja e çerdhes së re në lagjen "Dardania", e cila gjithashtu do të kërkojë staf shtesë dhe norma të reja.

Drejtoria e Arsimit ka adresuar kërkesat për rritje të normave në Ministrinë e Arsimit, e cila në bazë të informatave i ka përfshirë ato në Grantin Specifik për Arsim, por deri më tani nuk ka pasur reflektim në rritjen e normave tona.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe përkrahjen tuaj, ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunimin, në të mirë të proceseve arsimore.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## **R R E G U L L O R E**

Nr. \_\_\_\_\_

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE FORMAVE PËR  
DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS  
PËR MË PAK SE 1 (NJË) VIT**

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, nenit 17, pika f dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/2008), dispozitave të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit nr.06.L/092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 10/2019), dispozitave të nenit 7 të Rregullores 09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_, miratoi këtë:

## **R R E G U L L O R E**

### **PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE FORMAVE**

### **PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR MË PAK SE 1 (NJË) VIT**

#### **I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat dhe format për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit.

##### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e Komunës, personat fizik dhe juridik.

##### **Neni 3**

##### **Subjektet përfituese**

Prona e paluajtshme e komunës mund t'u jepet në shfrytëzim të gjithë personave fizik dhe juridik, që janë të evidentuar dhe regjistruar si shtetas të Republikës së Kosovës.

##### **Neni 4**

##### **Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin, ashtu siç është e përkufizuar me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

## **Neni 5.**

### **Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës**

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:

- 1.1. Parimi i ligjshmërisë - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;
- 1.2. Parimi i efikasitetit - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe me sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;
- 1.3. Parimi i trajtimit të barabartë të palëve - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;
- 1.4. Parimi i transparencës - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;
- 1.5. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrë që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;
- 1.6. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës - nënkupton se, shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi

## **Neni 6**

### **Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit**

1. Prona e paluajtshme e komunës e cila mund të jepet në shfrytëzim për më pak se një (1) vit është si vijon:

- 1.1. Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet);
- 1.2 Hapësirat publike para lokaleve;
- 1.3 Hapësirat publike rreth vend punishteve.
- 1.4 Shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot dhe fushat sportive

## **Neni 7**

### **Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:

- 1.1 Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastral të pronës;
- 1.2 Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;
- 1.3 Të mos ketë masë sigurie nga Gjykatat kompetente;
- 1.4 Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;
- 1.5 Të ketë arsyeshmërinë e interesit publik ose rritjes së vlerës së pronës;
- 1.6 Të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë;

## **Neni 8**

### **Procedura për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një vit**

1. Prona e paluajtshme e Komunës jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një vit për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes një kërkesë zyrtare me shkrim.

2. Kërkesat për dhënien në shfrytëzim për hapësirat sipas pikës 1.1, 1.2 dhe 1.3 të nenit 6 të kësaj Rregullore, i drejtohen Drejtorisë së Shërbimeve Publike e cila është e obliguar ta përcjellë për shqyrtim dhe vendosje në Komisionin përkatës për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat e përcaktuara në këtë paragraf.

3. Kërkesat për dhënien në shfrytëzim për pronat sipas pikës 1.4. dhe 1.5. të nenit 6 të kësaj Rregullore, i drejtohen Drejtorisë së Pronave e cila është e obliguar ta përcjellë për shqyrtim dhe vendosje në Komisionin përkatës për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat e përcaktuara në këtë paragraf.

## **Neni 9**

### **Kushtet për aplikim**

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, kërkesës duhet t'ia bashkëngjeshin këto dokumente:

- 1.1 Formularin e plotësuar
- 1.2. Kopjen e letërnjoftimit për personat fizik
- 1.3. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik
- 1.4. Projektin Ideor në kopje fizike dhe elektronike
- 1.5. Vërtetimi për përmbushjen e obligimit të tatimit në pronë dhe taksave komunale.

## **Neni 10**

### **Shqyrtimi i kërkesave**

1. Nga momenti i pranimit të kërkesave në drejtoritë përkatëse të përcaktuara në nenin 8 të kësaj Rregullore, me se largu brenda dy dite, kërkesën me dokumentacionin përcjellës ia përcjell për shqyrtim dhe vendosje të Komisionet përkatëse të themeluara nga Kryetari i Kryeqytetit.
2. Për shqyrtimin e kërkesave, Kryetari i Kryeqytetit i themelon Komisionet si në vijim:
  - 2.1. Komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat e parashtruara në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, e cila përbehet nga tre anëtarë, dy prej të cilëve janë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe një nga Zyra Ligjore; dhe
  - 2.2. Komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat e parashtruara në Drejtorinë e Pronave, dy prej të cilëve janë nga Drejtoria e Pronave dhe një nga Zyra Ligjore.
3. Komisionet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni kanë për obligim që brenda afatit prej 15 ditësh ta bëjë shqyrtimin e kërkesave dhe të vendosin lidhur me kërkesën.
4. Para marrjes së vendimit, Komisioni përkatës ka të drejtë për të kërkuar informacionet e nevojshme në Drejtoritë përkatëse dhe destinimet e pronave, ndërtesave dhe hapësirave publike, të cilat janë objekt i kërkesës së palëve.
5. Pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni përkatës merr vendim për aprovimin ose refuzimin e kërkesës. Në rastet kur aprovohet kërkesa, drejtoritë përkatëse të përcaktuara me këtë Rregullore, pasi që të ketë kaluar afati për shqyrtimin e ankesave, e përgatitin kontratën në bazë të vendimit të komisionit përkatës dhe të njëjtën ia dërgojnë për nënshkrim Kryetarit të Kryeqytetit.

## **Neni 11**

### **Parashtrimi dhe zgjidhja e ankesave**

1. Kundër vendimeve të Komisioneve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen lidhur me kërkesat, pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit përkatës, ka të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave brenda afatit prej 5 ditë pune pas njoftimit të vendimit.
2. Ankesa i drejtohet Komisionit të Ankesave të Komunës i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës.

3.Përbërja e Komisionit do të jetë prej 3 anëtareve, dhe mandati i tij do të jetë 2 vite,me mundësi vazhdimi.

4.Komisioni duhet të bëjë shqyrtimin e ankesave dhe të marrë vendim në afat prej 7 dite pune pas përfundimit të afatit kohor për paraqitje të ankesave.

5.Komisioni i ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të palëve ka të drejtë të vendosë si në vijim:

5.1. E refuzon ankesën si të pa bazuar dhe e lënë në fuqi vendimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen për kërkesën e palës;

5.2. E aprovon ankesën dhe e shfuqizon vendimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen për kërkesën e palës;

5.3. E shfuqizon vendimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen për kërkesën e palës dhe çështjen e kthen në rivendosje në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave.

6. Komisioni për ankesa gjatë vendimmarrjes vepron në bazë të ligjit për procedurën administrative, të ligjit material që rregullon çështjen e pronave si dhe në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

7. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankesave, merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

## **Neni 12**

### **Dhënia në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Organizatat e Shoqërisë Civile**

1.Organizatat e Shoqërisë Civile të cilët kanë për qëllim promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, arkitekturën historike, panaiet, aktivitetet për promovimin e barazisë gjinore dhe aktivitete të ngjashme me këto, aktivitet e të cilave zgjasin jo më shumë se 7 ditë, prona e paluajtshme u jepet në shfrytëzim pa kompensim.

2.Organizata e Shoqërisë Civile të cilat ushtrojnë veprimtari apo aktivitete rehabilituese për personat me nevojë të veçanta, prona e Komunës gjithashtu u jepet në shfrytëzim pa kompensim jo më shumë se 5 ditë.

3. Shfrytëzuesi i pronës sipas nenit 12 pas kalimit të kontratës duhet që pronën e marrë në shfrytëzim është i obliguar që ta kthejë në gjendjen e mëparshme.

**Neni 13**  
**Kontrata për shfrytëzim të pronës së paluajtshme**

1. Pas kalimit të afatit të ankesës, Kryetari i Kryeqytetit brenda 7 ditëve të punës lidhë kontratën me palën përfituese, me të cilën përcaktohen te drejtat dhe detyrat në mes të Komunës dhe përfituesit.
2. Kontrata duhet ti përcaktojë subjektet nënshkruese të kontratës, qëllimin, shumën e mjeteve financiare për kompensim, afatet kohore, detyrat dhe përgjegjësitë e palëve, monitorimin, raportimin, hyrjen në fuqi si dhe pjesë të tjera relevante për kontratën.
3. Menaxhimi i kontratës së nënshkruar sipas paragrafit 1, të këtij neni e bene Drejtoria përkatëse e përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 10 të kësaj Rregullore.
4. Shfrytëzuesi i pronës pas kalimit të kontratës duhet që pronën e marr në shfrytëzim për më pak se një vit është i obliguar që ta kthejë në gjendjen e mëparshme
5. Çmimet e kompensimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një vit, janë të përcaktuara në bazë të çmimeve të përcaktuara me Rregulloren përkatëse për taksat nga Kuvendi i Kryeqytetit.

**II. DISPOZITAT NDESHKUESE**

**Neni 14**

1. Personi fizik dhe juridik i cili nuk i përmbahet dispozitave të kësaj rregulloreje, i shkëputet kontrata.
2. Personi fizik dhe juridik i cili e ka dëmtuar pronën komunale të dhënë në shfrytëzim, kundër tij do të ndiqen procedurat ligjore në gjykatën kompetente për kompensimin e dëmit të shkaktuar dhe të njëjtit nuk do i jepet në shfrytëzim prona komunale, nëse ndaj të njëjtit gjykata e ka konstatuar shkeljen me vendim të formës përfundimtare.
3. Personi fizik dhe juridik i cili nuk i përmbahet dispozitave të nenit 13 paragrafit 13.2 dhe 13.5 të kësaj rregulloreje dhe dispozitave të kontratës, i shkëputet kontrata e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një vit.

**III. DISPOZITAT KALIMTARE**

**Neni 15**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje të gjithë personat fizik dhe juridik që janë duke e shfrytëzuar pronën komunale sipas rregulloreve të tjera, mund të i jepet e drejta për shfrytëzim edhe për një vit, nëse i plotësojnë kushtet për aplikim sipas kësaj rregulloreje dhe dëshmojnë me dëftesë bankare se i kanë kryer obligimet paraprake për kompensimin sipas rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.



2. Personat fizik dhe juridik sipas nenit 15 paragrafi 1 duhet të aplikojnë në pajtim me dispozitat e kësaj Rregullore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një vit.

#### **IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

##### **Neni 16**

Të hyrat e komunës nga dhënia e pronës së paluajtshme në shfrytëzim

Të hyrat nga dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës, konsiderohen të hyra vetanake të komunës, dhe i nënshtrohen respektimit të plotë të legjislacionit për menaxhimin e financave publike dhe ligjit për financa lokale.

##### **Neni 17**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimi në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**

\_\_\_\_\_, më \_\_\_\_\_

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Fehmi Kupina**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c) e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, 4 Qershor 2008), nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 36, paragrafi 3 i Rregullës financiare nr. 01/2013 – MF - Shpenzimi i parave publike dhe në bazë të nenit 52, pika h) dhe nenit 33, paragrafi 33.1, pika a) e Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më \_\_/\_\_/\_\_\_\_, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES**

### **PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NGA KOMUNA E PRISHTINËS**

#### **Neni 1** **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës e miratuar me datën 2.06.2025 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja bazike).

#### **Neni 2**

Neni 23 i Rregullores bazike, paragrafi 2, riformulohet si në vijim: Pagesa e qirasë së banimit bëhet për një periudhë prej pesë (5) vite, përveç në rastet kur Komuna nuk mund të bëjë zgjidhje tjetër, e njëjta mund të vazhdojë vetëm edhe për pesë vite të ardhshme.

### **Neni 3**

Neni 28 i Rregullores bazike, riformulohet si në vijim: Komuna mund të ndajë subvencione për shpenzimet e funeralit për anëtarët e ngushtë të personit të vdekur, deri në shumën prej 400 euro, e cila fillon të zbatohet nga data 01.01.2026.

### **Neni 4**

#### **Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimi në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Fehmi Kupina**